



Qeveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

PLANI HAPËSINOR

Zona e Interesit të Veçantë
“SHTABI I PËRGJITHSHËM I UÇK-ËS KLEÇKË DHE DIVJAKË”



Instituti për Planifikim Hapësinor



Qeveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës



Instituti për Planifikim Hapësinor

PLANI HAPËSINOR

Zona e Interesit të Veçantë

"Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-ës Kleçkë dhe Divjakë"

Dokument i përgatitur nga Instituti për Planifikim Hapësinor
në bashkëpunim me sektorët tjerë të Qeverisë së Kosovës.

Vërejtje!

Versioni kompetent i dokumentit është versioni në gjuhën shqipe.

Prishtinë, Shkurt 2012.

Hartues të Planit:

Instituti për Planifikim Hapësinor

Drejtor: Luan Nushi

Koordinator i projektit: Shpend Agaj,

Anëtarët e Grupit punues ndërministror:

Shpend Agaj (IPH), Festa Nixha-Nela (IPH), Rizah Murseli (IPH), Besim Gollopeni (IPH), Adnan Elshani (DPH), Haxhi Shala - MFSK dhe Naim Kelmendi - MTPT;

Planer dhe hulumtues në fusha përkatëse nga IPH:

Luan Nushi, Faton Deva, Arbën Rrecaj, Elvida Pallaska, Zana Mehmeti, Nexhmije Kamberi, Gëzime Grajqevci, Ismail Gagica, Mimoza Kallaba.

Përgatitja e hartave - Sektori i GIS-it: Rizah Murseli dhe Festa Nixha-Nela

Përgatitja teknike - Instituti për Planifikim Hapësinor

Pjesëmarrës tjerë nga:

Komunat pjesëmarrëse në zonë - Komuna e Drenasit, Malishevës dhe Lipjanit; Shoqata e veteranëve të UÇK-së dhe banorët vendas.

FALËNDERIM

Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit e grupit punues ndërministror (GPNM), përfaqësues të komunave e të organizatave publike qeveritare dhe joqeveritare si dhe ekspertë tjerë profesional, për kontributin e dhënë në takimet e organizuara, me qëllim të ndihmës dhe mbështetjes së MMPH-së gjegjësisht Institutit për Planifikim Hapësinor, në hartimin dhe ngritjen e cilësisë së këtij dokumenti:

Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë - "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-ës Kleçkë dhe Divjakë"

Parathënie

Plani Hapësinor i Zonës me Interes të Veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-ës Kleçkë dhe Divjakë” është një projekt që ka qenë shumë sfidues për të gjithë ne - për Qeverinë që kanë bërë shpalljen e zonës me interes të veçantë, dhe për Ministrinë tonë që ka qenë bartëse e procesit për hartimin e dokumentit.

Ky Plan është hartuar në bashkëpunim me të gjithë sektorët relevantë të Qeverisë së Kosovës. Gjithashtu, në hartimin e tij, kanë kontribuar profesionistë të dalluar të kësaj fushe, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta, organizata të ndryshme joqeveritare dhe shoqëria civile. Ndihma e përkrahja që ofruan zyrtarët e nivelit lokal dhe përfaqësues të komunitetit që jetojnë në këtë zonë ishte shumë e rëndësishme.

Hapësira për të cilën kemi hartuar planin hapësinor është e njohur për sakrificën e popullit të kësaj ane, të cilën e treguan gjatë luftës së fundit në Kosovë. Përkundër varfërisë së tyre të madhe ata kanë ofruar ndihmë dhe strehim për ushtarët e UÇK-së dhe për popullatën e shpërngulur gjatë luftës. Kjo zonë ishte gjithashtu selia e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe Malet e Berishës ishin vendi ku nisën rreshtimet ushtarake dhe trajnimet e para të UÇK-së.

Plani Hapësinor i Zonës me Interes të Veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-ës Kleçkë dhe Divjakë” është në përputhje me standardet kryesore që dalin nga ligjet e vendit dhe rregulloret evropiane. Ky dokument është gjithë-përfshirës, dhe parasheh zhvillimin e baraspeshuar dhe të qëndrueshëm dhe promovon transparencë të plotë në planifikim.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, kjo që është realizuar deri tani është vetëm fillimi i aktiviteteve që Qeveria e Kosovës ka në plan të ofrojë për ruajtjen dhe promovimin e vlerave të historisë më të re të popullit të Kosovës.

Prandaj, në emër të MMPH-së përkatësisht të Institutit për Planifikim Hapësinor si hartues të planit, ju sigurojmë se zhvillimet e parashikuara në këtë Plan do të realizohen maksimalisht, duke ndikuar në ngritjen e mirëqenies ekonomike të popullatës lokale dhe ngritjen e përgjithshme ekonomike.



Dardan Gashi
Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Lista e shkurtimeve

Shkurtesa	Emërtimi
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
IPH	Instituti për planifikim Hapësinor
AMMK	Agjincioni për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë
PH ZV	Plani Hapësinor për Zonën e Veçantë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
SHP	Shtabi i përgjithshëm
QPK	Qeveria e përkohshme e Kosovës
ESDP	Perspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor
IUCN	Unioni ndërkombëtar për konservimin e natyrës
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
PRrU	Plani Rregullues Urban
VNM	Vlerësimi i ndikimit në mjedis
VSM	Vlerësimi strategjik mjedisor

Përmbajtja:

Hyrje.....	9
I. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR DHE ANALIZA E GJENDJES	15
1. Të dhëna gjeografike	15
1.1. Pozita gjeografike	15
1.2. Topografia e terrenit	16
1.3. Përshkrimi i kufirit.....	16
1.4. Përshkrimi i kufirit të zonës së zgjeruar	18
1.5. Ndarja e territorit të zonës sipas përkatësisë komunale.....	19
1.6. Karakteristikat hidrografike	20
1.7. Klima.....	20
1.8. Reshjet.....	20
1.9. Erërat.....	20
2. Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës	20
2.1. Mjedisi	20
2.2. Shfrytëzimi i tokës	21
3. Trashëgimia e Luftës së UÇK-ës.....	23
3.1. Zona Kleçkë - Shtabi i brigadës 121	25
3.2. Zona Divjakë - Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së	27
3.3. Varrezat e dëshmorëve.....	29
3.4. Zona në Novoselë.....	30
3.5. Radio Kosova e Lirë - shtëpia muze	31
3.6. Luzhnica	33
4. Popullsia dhe zhvillimi social	34
4.1. Numri i popullësisë	34
4.2. Dendësia e popullësisë.....	34
4.3. Struktura e popullësisë sipas moshës dhe gjinisë.....	34
4.4. Struktura etnike e popullësisë	34
4.5. Migrimet e popullësisë.....	34
4.6. Arsimi	34
4.7. Shëndetësia	35
4.8. Papunësia dhe varfëria.....	35
5. Infrastruktura	36
5.1. Infrastruktura e transportit.....	36
5.2. Infrastruktura e telekomunikacionit.....	37
5.3. Infrastruktura e energjetikës.....	38
5.4. Infrastruktura ujore	38
6. Kleçka dhe Divjaka në kontekst ekonomik	38
7. Analiza e gjendjes - SWOT	39
8. Vlerësimi i kapaciteteve investive për ZIV “ SHP: Kleçkë- Divjakë”	39
9. Sfidat e zhvillimit hapësinor të zonës	41
II. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET.....	45
III. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR.....	47
3. Koncepti dhe Struktura e Zhvillimit Hapësinor.....	47
IV. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR.....	51
4.1. Mjedisi, Trashëgimia Natyrore, Historike dhe Kulturore.....	51
4.2. Menaxhimi.....	52
4.3. Zhvillimi Social	52
4.4. Zhvillimi Ekonomik	52
4.5. Infrastruktura	53
Tabelat e strategjisë sipas synimeve të përcaktuara.....	55
V. DISPOZITAT PËR ZBATIM.....	63
5.1. Kushtet dhe masat të përcaktuara nga Qeveria, si dhe nga pushteti lokal mbi çështje të rëndësishme për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës në zonën e veçantë për të cilën hartohet plani.	64

5.2. Dispozitat lidhur me konsultimin, bashkëpunim dhe pjesëmarrje.....	69
5.3. Dispozitat mbi rendin kronologjik apo etapat e zbatimit.....	69
5.4. Elementet dhe udhëzimet për hulumtim të mëtutjeshëm	70
Anexet:.....	71

Hyrje

Planifikimi hapësinor dhe rëndësia e tij

Planifikimi hapësinor si proces siguron zhvillim hapësinor të planifikuar, balansuar dhe të qëndrueshëm, qeverisje të mirë si dhe shfrytëzim e mbrojtje të hapësirës, si vlerë të përgjithshme nacionale, gjithmonë duke i respektuar standardet evropiane dhe më gjerë.

Plani Hapësinor për Zona të Veçanta

Plani Hapësinor nënkupton planin për rregullimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin e hapësirës si:

- Territori i komunës – Plani Zhvillimor Komunal
- Zona e Veçantë – Plani Hapësinor për Zona të Veçanta
- Territori i Kosovës – Plani Hapësinor i Kosovës

Planet Hapësinore për Zona të Veçanta miratohen për zona të identifikuar në Plan Hapësinor të Kosovës që janë me karakteristika të veçanta dhe të cilat kërkojnë një rezhim të veçantë të organizimit, zhvillimit, shfrytëzimit dhe mbrojtjes. Ndër to mund të jenë edhe zonat me vlera kulturore ose historike.

Qëllimi i hartimit të Planit

Plani Hapësinor i Zonës me Interes të Veçantë „SHP UÇK-së Kleçkë – Divjakë”, paraqet një dokument me të cilin vihen nën mbrojtje të gjitha objektet me rëndësi të veçantë nga koha e luftës së UÇK-së në këtë zonë (shtabi përgjithshëm, spitalet, varrezat e dëshmorëve, pikat e rëndësisë luftarake, „Radio Kosova e Lirë”, bunkerët e luftës, kampet e refugjatëve të luftës etj.) si dhe monumentet e natyrës.

Procesi deri te hartimi i Planit

Hapat e parë rreth inicimit për shpallje të territorit si “Zonë e Interesit të veçantë” për shtetin e Kosovës, është nënshkrimi i “Memorandumit të Mirëkuptimit” në mes të komunave në territorin e të cilave i takon edhe “Zona” në fjalë, sipas të cilit: “Duke u bazuar në rolin dhe rëndësinë e luftës së UÇK-së në Kosovë, e në aksent të veçantë në territorin e komunave Lipjan, Malishevë dhe Drenas, ku për këto komuna dhe më gjerë, ka qenë i vendosur Shtabi i UÇK-së, në disa shtëpi private të fshatit Divjakë dhe Kleçkë, dhe me qëllim që të ruhet natyra e këtyre objekteve me rëndësi të veçantë ashtu sikurse ka qenë gjatë luftës, nga vullneti i lirë i këtyre komunave të lartshënuara, dhe pjesëmarrës aktiv të UÇK-së me datën 17.02.2010 është nënshkruar “Memorandumi” i cekur më lartë nga kryetarët e komunave gje gjëse.(për detaje shih aneksin 1, fq.69)

Hapi i radhës është Propozim Vendimi për Qeveri – Shpallja e interesit të përgjithshëm nacional për Zonën “Shtabi i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë” i datës 05.03.2010, e përgatitur nga Departamenti për Planifikim Hapësinor. Në këtë propozim është elaboruar arsyeshmëria, qëllimi dhe baza juridike se pse duhet shpallur si “ZIV” (për detaje shih në aneksin 2, fq.70) Dokumenti si i tillë është proceduar në Zyrën e Kryeministrit përmes sekretarit të përhershëm në MMPH (detajet në Aneksin 3, fq 78).

Më datën 30.03.2010, Qeveria e Kosovës mori Vendim, sipas të cilit: Hapësira ku ka qenë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, në Kleçkë dhe Divjakë, me sipërfaqe prej 1.500,29 ha në komunat Lipjan, Malishevë dhe Drenas, shpallet zonë me interesit të veçantë. (për hollësi tjera Anexi 4, fq.79).

Në fund, më datën 24.08.2010 Sekretari i përhershëm në MMPH nxjerr Vendim për formimin e Grupit Punues Ministror për hartimin e Planit Hapësinor për Zonën e Interesit të Veçantë "SHP: Kleçkë dhe Divjakë" (për detaje shih Aneksin 5, fq.80).

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për hartimin e Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta dhe në kudër të së cilës Instituti për Planifikim Hapësinor është emëruar bartës i hartimit të PH ZIV "SHP. UÇK. Kleçkë e Divjakë".

Historiku i vendbanimeve në zonë

Kjo zonë sa i përket trashëgimisë historike ende është e pa hulumtuar dhe si e tillë ka nevojë që të organizohen hulumtime ne terren me qëllim të ruajtjes konservimit të Kaluares historike.

Kleçka - Është vendbanim i vjetër autokton shqiptar i cili shtrihet ne shpatet e maleve të Caralevës në perëndim të Lypjanit, në të cilin kryesisht jetojnë familja Shala.

Në bazë të mikrotopnimeve të rrethinës së fshatit kuptohet edhe lashtësia e vendbanimit psh: Ahi i Gozhdës, Ahishta e Kokarrit, Ara e Rrajve, Bria e kuqe, Dardhishta, Fraja e Vrellës, Dardha Ukere, Vorret Kelmene, Groshet, Oda, Kroni i Alibashit, Kllaçka, Guri i Vorreve, Roga e Bllaçukit, Trojet e Kelmeneve. Trojet e Moçme, Tuçuki, Rrahma, Udha e Trojeve, etj ..

Ne Veriperëndim të fshatit Kleçkë 3 km distancë shtrihet Gradina që ndryshe quhet Gradina e Lladroviqit. Janë gjetur mbetje arkeologjike materiale të qeramikës ku konsiderohet si vendbanim shumë i vjetër i kohës romake që ende nuk esht hulumtuar.

Në malin Kleçka në Gradinë është gjetur nje Stellë romake që supozohet se gjendet në shtëpinë e Zenel Ramadanit. Në këtë pjesë janë gjetur edhe materiale të ndryshme metali, sëpata guri, pjesë të Kandarit romak, pjesë të mureve me material të pjekur apo tulla të kuqe etj. Në këtë zonë është gjetur edhe AREA me mbishkrimin: IOMTATTADATI (A) BLABIVS ETONTIA CVMLIBERIS.

Ne Livadhet e Kleçkës një topo gërmadhë quhet Trojet e Moçme dhe Trojet e Kleçkës ku ka gërmadha dhe shenja të një vendbanimi të vjetër i cili është zhdukur.

Sipas traditës popullore këtë zonë e kanë banuar fisi Kelmend. Familja Shala është vendosur në këtë zonë mbi gërmadhat e mbetura të fisit Kelmend

Gjatë te kalueses historike ky vendbanim ishte çerdhe e luftës kundër pushtuesve të ndryshëm ku ka luajtur rol te rëndësishëm ne traditën kombëtare. Kleçka gjatë vitit 1998-1999 ishte bazë ë e rëndësishme e UCK ku ne familjen Shala është vendosur Shtabi I Brigadës 121 „Ismet Jashari-Kumanova“.

Divjaka - Është vendbanim i vjetër autokton shqiptar. Këtë e dëshmojnë gjurmët arkeologjike të shumta. Mikrotoponimet karakteristike të Divjakës si dhe gjurmët arkeologjike në zonë janë të kohës Ilire.

Në vendin e quajtur „Lugu Zabelit“ janë gjetur vegla të ndryshme vorba, gurë të farkëtarëve, vegla të punës etj. Ne vendin e quajtur „Zabeli i Madh“ ekzistojnë gjurmë të varrezave të moçme. Në afërsi të kësaj zone janë edhe mikrotoponimet „Rogat e Kishës“ dhe “Livadhet e Kishës” ku dëshmon se aty ka ekzistuar kisha Ilire. Disa nga mikrotoponimet e Divjakës janë: Udha e serumeve, Rrutullaki, Seishtat, Rrahi i Bilalit, Livadhi i Kishës, Bota, Bunari i Rrezës, Ahishta e Gegës, Ahi i Gozhdës, Kisha, Kllaqka, Koritat, Krojet te Mullini, Livadhi i Butë, Rogat e Gata, Pusi i therrave, Udha e Bjeshkës, Zabeli i madhë, Trolli i Moçëm, Gllijat, Kroni i Krojes, Roga e Hysenit, Shavarinat Krojet etj.

Që nga periudha osmane kjo zonë është cilësuar si strehë e aktivistëve të gjeneratave per çështje kombëtare. Gjatë luftës së dytë botërore ne këtë zonë ka qen i vendosur edhe spitali ushtarak i partizanëve.

Aktivitetet e shumta të brezave të pas luftës dytë botërore kanë veprua në këtë zonë kundër regjimit ish Jugosllav. Gjatë Luftës 1998-99 në këtë zonë ka funksionu SHP-UÇK, spitali

ushtarak, njësitë e logjistikës etj. Në këtë vendbanim kanë gjetur strehë gjatë luftës me mija banorë të zonave përreth.

Novosella - Është vendbanim i vjetër autokton shqiptar. Këtë e dëshmojnë gjurmët arkeologjike të shumta. Mikrotoponimet karakteristike të fshatit janë: Ara e Lekës, Varret e Kelmendve, Livadhi i Dervenit, Roga e Kishës, Varret Vortull, Udha Bam-Bam, Derveni etj. Në bazë të mikrotoponimeve ky vendbanim ka qenë i banuar shumë herët. Në lindje të fshatit në zonën e quajtur Derven janë gjetur gjurmë të hershme arkeologjike: tulla guri, tjegulla vegla të ndryshme etj.

Shtrirja hapësinore e fshatit ka pozitë të përshtatshëm gjeostrategjike andaj shumë aktivitete ushtarake të luftës së UCK janë zhvilluar në këtë zonë. Selia e Qeveris së Përkohshme ka qenë në fshatin Novosela. Pas shumë tentativave të forcave okupuese asnjë herë nuk kanë mundur të pushtojnë këtë fshat gjatë luftës 98-99.

Berisha - Shtrirja gjeografike e fshatit Berishë në majën e maleve Berishë dhe ndarja në lagje në shpatijet e saj ka bërë që kjo zonë të jetë epiqendër e aktiviteteve të ndryshme nga koha ilire deri me sotë. Ky vendbanim në bazë të gjetjeve arkeologjike rezultoi të jetë i banuar nga koha ilire. Mbetjet arkeologjike në rrëzë të maleve të Berishës të Guri Gradinës janë gjetur materiale arkeologjike ku mendohet se ka qenë një fortesë natyrore si dhe ndërtime të kohës së vjetër në drejtim të Llapushnikut.

Në perëndim të fshatit në zonën e quajtur Sumullari janë gjetur gjurmë vendbanimi. Në Pallanik (pallatet e Nikës) njashtu janë gjetur mbetje arkeologjike. Mikrotoponimet e fshatit Berishë kryesore janë: Bregu i Kerqelëve, Kodra e Mollamahmutit, Ahishta, Ara e Korubës, Bleshmarku, Mrizet, Sumullari, Ballishta, Vorret, Roga, Kranja etj. Berisha me rrethin njihet për rezistencë të pa ndërprerë ndaj pushtuesve të huaj.

Gjatë luftës dytë botërore kjo zonë ka qenë cak i sulmeve të pa ndërprerë. Në këtë zonë shquhet luftëtari për liri Rifat Berisha që ka edhe përmendoren në fshat si dhe Shkolla mban emrin tij. Një ashtu në këtë fshat dhe me gjerë njihet edhe figura e ndritur e plakut të mençur dhe dijetarit Tahir Berisha. Në vitet 98-99 në këtë zonë ka vepruar UCK si dhe kanë gjetur strehë me mija banorë të Kosovës si refugjat lufte. Në Berishë për herë të parë ka funksionuar Radio Kosova e lirë dhe Kosova-Pressi.

Objektet e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje institucionale në zonën „Shtabi përgjithshëm Kleçkë-Divjakë”.

Emri	Koha	Viti shpalljes nën mbrojtje	Vendi
Lokalitet arkeologjik „Qytezë”	Shek.VI-P.e.s	1983	Kleçkë
Lokalitet arkeologjik „Qytezë”	Shek.VI-P.e.s	1983	Baincë
Kishë varrore „Shën Teodor Tironit”	Shek XVI	1988	Në mes fshatit Berishë -Novosellë

Historiku i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së

Vargmalet e Berishës, sidomos Divjaka, Kleçka, Berisha, Fshati i ri e vendbanime të tjera të kësaj treve të Llapushës, në kohë të vështira, sidomos nën pushtimin jugosllav, ishin çerdhe të strehimit dhe të veprimit të forcave atdhetare shqiptare, që angazhoheshin për çlirim e bashkim kombëtar. Djemtë dhe vashat më të mira, më të guximshme të popullit shqiptar, kishin gjetur strehim në Divjakë.

Pas formimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, më 17 nëntor 1994, një kohë takimet e kreut të saj mbaheshin pikërisht në Divjakë. Në pranverë të vitit 1998, në Divjakë, është vendosur Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Shërbimi Informativ Kombëtar,

Drejtoria operative dhe Njësia speciale vëzhguese-diversante e SHP të UÇK-së. Në këtë fshat, ka funksionuar edhe Spitali ushtarak dhe kuzhina e UÇK-së.

Ndërkaq, në Kleçkë, në odën e familjes së Hafir Shalës, dëshmorit Sadik Shala, ka qenë selia e Shtabit të Njësitit Çeliku dhe të Brigadës 121 Ismet Jashari – Kumanova. Herë-pas-herë, këtu kanë qëndruar edhe drejtues të lartë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Këtu, më 14 qershor 1998, ekipi i RTSH-së, ka realizuar paraqitjen e parë publike të zëvendëskomandantit të SHP të UÇK-së e zëdhënës i UÇK-së, Jakup Krasniqi.

Në Kleçkë, më 26 qershor 1998, për RTSH dhe mediat botërore është bërë edhe xhirimi i parë të betimit të ushtarëve të UÇK-së të Zonës operative të Pashtrikut.

Në Fshat të Ri, ka vepruar Drejtoria politike e UÇK-së dhe ka qenë selia e parë e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, të udhëhequra nga Hashim Thaçi. Qeveria e Përkohshme ishte formuar në bazë të Marrëveshjes së forcave politike të Kosovës të përfaqësuara në Konferencën ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje. Këtu Qeveria e përkohshme, ka majtë edhe takimet e rëndësishme me diplomatë e ushtarakë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, James Rubin, Shown Bërns e të vendeve evropiane.

Në Berishë, ka qenë selia e dy institucioneve të para të UÇK-së: Agjencisë së lajmeve "Kosovapress" dhe të Radios Kosova e lirë. Këto 2 institucione, kanë filluar punën zyrtarisht më 4 janar të vitit 1999.

Në Luzhnicë, ka qenë selia e Shtabit të Batalionit të tretë "Sadik Shala" i Brigadës 121 të UÇK-së, që komandohej nga Ismet Jashari – Kumanova. Në trevën e vargmaleve të Berishës, në Kleçkë, Divjakë, Fshat të ri, Berishë, Llapushnik, Luzhnicë, Javur, në Tërpezë, në Lladrovc, në Shalë, Baicë, Kizharekë, Nekoc, kanë vepruar shtabet e njësiteve të Brigadës 121 të UÇK-së, njësite të specializuara të SHP të UÇK-së dhe institucionet më vitale të luftës.

Në trevën e Llapushës, saktësisht në vargmalet e Berishës, janë zhvilluar shumë beteja frontale midis forcave pushtuese serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ndër to duhet veçuar betejën në Gryken e Llapushnikut në Maj e Korrik 1998, atë në Luzhnicë, më 24 e 25 gusht 1998, si dhe shumë beteja të tjera në Lladrovc, në pranverë e verë të vitit 1999.

Në këtë zonë, nën uniformën e UÇK-së, kanë vepruar disa mija luftëtarë të UÇK-së, kurse populli i kësaj ane e ka mbështetur me të gjitha mjetet e mundësitë e veta luftën e UÇK-së deri në çlirimin definitiv të Kosovës.

Zona e Divjakës dhe e Kleçkës, ka qenë ndër zonat më strategjike të luftës së UÇK-së, nga se këtu vepronte SHP i UÇK-së, njësitet elite të tij dhe institucionet më vitale të luftës, si dhe mbaheshin takimet e nivelit më të lartë me diplomatët euro-perëndimorë.

Nga kjo zonë, mbaheshin të gjitha komunikimet me zonat e tjera të luftës në Kosovë, si dhe bëhej organizimi i logjistikës ushtarake dhe civile. Në periudhën e ofensivave luftarake me forcat serbe, në vendbanimet përgjatë vargmaleve të Berishës, gjetën strehim, mbrojtje dhe përkujdesje nga UÇK-ja mbi 85 mijë civilë. Për ta u sigurua ushqimi, veshmbathja, përkujdesja shëndetësore dhe për fëmijët u organizua edhe zhvillimi i procesit mësimor në shkollat-tenda. Pas luftës, në Kleçkë janë rivarrosur të gjithë dëshmorët e Brigadës 121 "Ismet Jashari – Kumanova."

Duke e pasur parasysh rëndësinë historike të zonës, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është shpallë Zonë e Interesit të Veçantë.

Bazueshmëria e Planit

Plani hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë „SHP. UÇK. Kleçkë-Divjakë” bazohet në legjislacionin në fuqi. Baza ligjore mundëson përgatitjen e planeve hapësinore për zona të veçanta, të një regjimi të veçantë të organizimit, zhvillimit, shfrytëzimit, mbrojtjes, si dhe ruajtjes së identitetit socio-kulturor të Kosovës, të identifikuar në Planin Hapësinor të Kosovës.

Gjatë hartimit të këtij plani hapësinor janë marrë për bazë këto ligje:

Ligji për Planifikim Hapësinor (Nr. 2003/14);

Ligji për ndryshimin e ligjit për Planifikim Hapësinor (Nr. 03/L-106);

Ligji për mbrojtjen e mjedisit (Nr. 03/L-025);

Ligji për mbrojtjen e natyrës (Nr. 02/L-18);

Ligji për ujrat e Kosovës (Nr. 2004/24);

Ligji për tokën bujqësore (Nr. 02/L-26);

Ligji për Rrugët nr. 2003/11

Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (2010 03/L-139);

Ligji për Gjuetinë (2005/2-L53)etj

Plani do të përfillë këto parime:

- Të ketë qasje të integruar, e cila përfshin elementet hapësinore të zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor, të infrastrukturës dhe politikat e tjera strategjike për territorin për të cilin nxirret Plani;
- Plani duhet të ketë parasysh kontekstin e gjerë hapësinor dhe duhet të ketë kujdes të veçantë për çështjet ndër komunale;
- Plani duhet të përmbajë politikat dhe kriteret për përcaktimin e propozimeve zhvillimore.

Pas hartimit të Planit, MMPH dorëzon dokumentin në Qeveri, e cila pas aprovimit e dërgon në Parlament për aprovim final.

Përmbajtja e planit

Dokumenti i Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë„SHP. UÇK. Kleçkë-Divjakë” përmban pjesën tekstuale dhe atë grafike. Pjesa tekstuale përmban:


1. Profili i zhvillimit hapësinor dhe analiza e gjendjes;
2. Vizioni, parimet dhe caqet;
3. Korniza e zhvillimit hapësinor;
4. Strategjia dhe veprimet për zbatim;
5. Dispozitat për zbatim

I PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR DHE ANALIZA E GJENDJES

1. Të dhëna gjeografike

1.1. Pozita gjeografike

Zona me Interes të Veçantë „SHP. UÇK. Kleçkë-Divjakë” shtrihet ne pjesën qendrore të Republikës së Kosovës në tri komuna: Malishevë, Drenas dhe Lypjan me sipërfaqe 1500.29 ha. Pozita është e favorshme nga se qasja në këtë zonë është e mundur nga tri komunat që kanë lidhje të mira rrugore me tërë territorin e Kosovës. Si tërësi zonale konsiderohet pikë strategjike, nga Malet e Berishës rreth 75% e tërë territorit të Kosovës shihet me anë të syrit të lirë. Nga Kodra Ferinë me 1042m lartësi mbidetare dhe Kodra e Nezirit 1001-1013m lmb vëzhgohen dy tërësi regjionale Rrafshi i Dukagjinit dhe Fusha e Kosovës. Pozita e tillë gjeostrategjike ka bërë të mundshme zhvillimin e aktiviteteve ushtarake dhe politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



Harta 1. Pozita gjeostrategjike e ZIV „SHP. UÇK. Kleçkë dhe Divjakë” (IPH)

1.2. Topografia e terrenit

Zona e Interesit të Veçantë “SHP UÇK Kleçkë-Divjakë” shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës me lartësi mbidetare 900-1025m. Kurrizi malor lidhet nëpërmjet grykave malore me dy regjionet e Kosovës. Me rrafshin e Kosovës lidhet nëpërmjet grykave lumore të Banjices, Prronit të thatë, grykës së Nekovcit, grykës së Kishna Rekës, Gurgacit etj., ndërsa me Rrafshin e Dukagjinit lidhet nëpërmjet Prronit të Bujupit, Prronit të Bitiqit, Tërpezës, Lladrovcit, Senikut dhe përmes kurrizit malor lidhet me qafën e Carralevës.

1.3. Përshkrimi i kufirit


Sipas vendimit të Qeverisë Zona e Interesit të Veçantë shtrihet në Malet e Berishës , përbëhet nga 3 zona. Zona e komunës së Drenasit me sipërfaqe prej 1354.67 ha, e cila në veri shtrihet në kuotën 792m lmb në kufi me Lagjen Tahiri, Haradinaj dhe Lagjen e Gurit. Në veri lindje kalon në kuotën 750m në Ravnishtë në lindje të Lagjes Mulaku dhe Vilaku, pastaj kalon në lindje të Fshatit Kishnarekë në kuotë 800m lmb. Në vazhdim kalon në kuotën 814m në Malin Qukë dhe Lagjen e Lugut. Në lindje shtrihet në kuotën 828-875m lmb në Malin Kodra, që shtrihet në perëndim të vendbanimit Plakiq, vazhdon me kuotën më të ultë 550m lmb në VL të Fshatit Bainsë. Në jug kalon në kuotën 869m deri në kuotën 957 Maja e Madhe, pastaj kalon në 850m lmb në Malin Korija në lindje të fshatit Divjakë. Më tej vazhdon me kuotën 963m lmb, pastaj në Lindje me Malin Ahishta 805m lmb deri në Malin Lisiqinë. Kufiri prapë kthehet në drejtim jugor, kufizohet me Malin Gjalla apo me Lagjen Berisha në lartësi mbidetare 1014m. Kah lindja shkon në mes të Malit Puhavicë dhe Dobra Voda deri në perëndim të Mëhallës Bitiq, vazhdon me kuotën 777m lmb të Malit Karabreg, pastaj kalon në Lagjen e Gjamijes, Lagjen Bujup dhe përmbillet me Lagjen Tahiri në veri.

Zona e Komunës së Lypjanit e cila përfshin Kleçkën dhe Divjakën dhe ka një sipërfaqe prej 39.18 në përbërje të së cilës janë dy zona. Zona e Divjakës që në veri kufizohet me Lagjen e Lugut, në lindje me Fshatin Divjakë, në jug me Malin Oranc në kuotën 1001m lmb dhe në perëndim me Kodrën e Nezirit në kuotën 1023m lmb. Zona e Kleçkës e cila shtrihet në kuotën 1024m në perëndim të Fshatit Kleçkë.

Zona e Komunës së Malishevës me një sipërfaqe prej 111.38 ha, e cila në veri shtrihet nga Kodra e Nezirit në kuotën 1023m lmb, në lindje vazhdon me Fshatin Kleçkë, në jug me Malin Gradina dhe në përnderim vazhdon me Malin Cer dhe Grape.

Pamje e terrenit të zonës






Harta 2. Kufiri i ZIV „SHP UÇK - Kleçkë dhe Divjakë “ (IPH)

Pas diskutimeve dhe analizave të bëra grupi punues që ka hartuar planin hapësinor të „ZIV Kleçkë-Divjakë“, ka vendosur ta zgjerojë kufirin e zonës me arsyetim të mbrojtjes së vlerave të natyrës, trashëgimisë kulturore historike të luftës së UÇK-së, të pengimit të zhvillimeve të pa dëshiruara në zonë, si dhe të kontrollimit të zhvillimeve të vendbanimeve, bizneseve, turizmit, dhe veprimtarive të ndryshme në zonë. Propozimi për kufirin e ri i mbron vlerat e kësaj zone.

1.4. Përshkrimi i kufirit të zonës së zgjeruar

Në Veri ZIV „SHP.UÇK. Kleçkë-Divjakë, kufizohet me Lagjen Bujupi, Tahiri, Haradinaj, Hajdaraj dhe Lagjen e Gurit. Në VL kufizohet me Lagjen Mulaku, me Vilak dhe Kishanrekë. Në lindje me Lagjen e Lugut, Plakiqit, Banjicë dhe në juglindje me fshatin Shalë. Në jug kufizohet me ujë rrjedhën e Klysyrrës së Shalës deri te trekëndëshi Shalë-Kleçkë-Qafa e Dulës dhe më tej vazhdon me kuotën 1055m me Malin Gradina. Në jugperëndim kufizohet me Lagjen Ramaj, Fushën e Senikut dhe Fshatin Lladrovç. Në perëndim kufizohet me Lagjen Meta, Muhagjeri, Mustafa dhe Zymeri. Në VP kufizohet me Lagjen Biti, Lagjen e Xhamisë dhe Lagjen Bujupi.





Harta 3. Kufiri i propozuar i ZIV “SHP. UÇK. Kleçkë dhe Divjakë” (IPH)

1.5. Ndarja e territorit të zonës sipas përkatësisë komunale

Sipërfaqja e tashme e ZIV është 39km², prej të cilës 16km² ose 41% e sipërfaqes i përket Komunës së Drenasit, 10km² ose 26% e sipërfaqes i përket Komunës së Lypjanit dhe 13km² ose 33% e sipërfaqes i përket Komunës së Malishevës.

Komunat	Km2
Lipjani	10.00
Gllgovci	16.00
Malisheva	13.00
Total	39.00



Harta 4. Pjesëmarrja territoriale e komunave në ZV "SHP. UÇK.Kleçkë dhe Divjakë" (IPH)

1.6. Karakteristikat hidrografike

Kjo zonë nuk ka rrjet të zhvilluar hidrografik. Disa burime ujore janë të qëndrueshme edhe gjatë stinës së thatë të vitit. Në zonë ka ujëra rrjedhës të prrockave dhe përrenjve. Kualiteti i ujit është i mirë. Zona është ujëndarës i dy pellgjeve detare: pellgut të Detit Adriatik dhe atij të Detit të Zi.

1.7. Klima

Zona karakterizohet me klimë të mesme kontinentale dhe malore, ndërsa përmes Drinit të Bardhë depërton klima e ndryshuar mesdhetare.

1.8. Reshjet

Gërshetimi i tipave klimatik në mes të dy regjioneve të Kosovës, atë të Rrafshit të Dukagjinit dhe Fushës së Kosovës bën që ky regjion të jetë me reshje mesatare si dhe me reshje të mëdha bore sidomos nga fundi i dhjetorit deri në fund të muajit shkurt.

1.9. Erërat

Karakteristikë e këtij regjioni janë erërat që ndikohen nga dy anët e Kosovës. Si zonë është e ekspozuar edhe ndaj erërave veriore edhe ndaj atyre jugore.

2. Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës

2.1. Mjedisi

Pasurinë e një kombi e përbëjnë burimet njerëzore, ekonomike dhe mjedisore, këto janë të lidhur në mes vete, ndër veprimet së bashku dhe si të tilla nuk mund të shqyrtohen ndaras. Gjendja e krijuar pas luftës së fundit ka bërë që vendi ynë në të gjitha sferat të ballafaqohet me vështirësi të ndryshme që nuk i kanë pasur shtetet tjera të rajonit, në këtë aspekt, situatë më të mirë nuk ka mundur të ketë pasur as përkujdesja mjedisore dhe menaxhimi i tij.

Ajri - Në zonën Kleçkë-Divjakë është e evidente ndotja e ajrit, sepse në disa lokacione brenda zonës gjenden furrat për djegien e gëlqeres, që si lëndë të pare përdorin gommat, kështu ndotja e ajrit ndodh në kohën kur bëhet pjekja e gëlqeres, sepse pas këtij procesi lirohet në atmosferë metani dhe dioksidi i karbonit në formë tymi.

Uji - Zona karakterizohet me burime ujore, prrocka dhe përrenj. Rrjeti ujqor i takon kategorisë së parë (pa ndotje). Janë disa shkarkime ilegale të mbetjeve që duhet mënjanuar nga shtretërit e prrockava.

Burimet ujore prrockat dhe prrenjë të zonë janë:

Burimi Guragac – Berishë

Kroni Stakavic - Berishë

Uji i mirë -Lagja Bitiq

Prroni –Burimi i kësaj prrocke ne Berishë

Prroni i i Nekovcit

Liqeni i Plakiqit

Prroni Tat (Burimet e prronit janë ne mes Divjakës dhe Lagjes Ismajli)

Burimet te kodra e Nezirrit

Burimet ne Grape

Prroni Grika e Baines (burimi ne malet e Ornicës)


Prrocka e Cerit

Kroni i Kaljit –Kleçkë

Prroni i Kleçkës apo e Shalës

Kroi i Kuq – Shalë

Zona konsiderohet me rrjet hidrografik te rrallë. Shumë nga burimet e ujit me kaptash shfrytëzohen nga banorët lokal.



Harta 5. Hidrografia në ZIV “SHP UÇK Kleçkë dhe Divjakë” (IPH)


Toka - Duke u nisur nga fakti se pjesa më e madhe e kësaj zone është malore dhe se në aspektin industrial nuk është e zhvilluar, prandaj sipërfaqet tokësore në aspektin mjedisor në pjesët më të mëdha janë të pastra, në përjashtim të lokacioneve ku gjenden furrat për djegien e gëlqerës dhe disa pika te grumbullimit të mbeturinave, prezente në zone.

2.2. Shfrytëzimi i tokës

Nga sipërfaqja e përgjithshme e Zonës me interes të Veçantë „SHP-Kleçkë-Divjakë”, pjesën më të madhe e zënë sipërfaqet me pyje me rreth 86.14%, pastaj vijnë kullosat dhe livadhet 7.66%, arat 5.14% dhe sipërfaqet e ndërtuara 1.06%.

Shfrytëzimi i tokës në ZIV Kleçkë dhe Divjakë

Kategoritë e shfrytëzimit të tokës	ha	%
Vendbanim	39.77	0.99
Shkollë me oborr	1.06	0.03
Lapidarë	1.54	0.04
Ara	207.61	5.14
Kullosë	309.76	7.66
Pyll	3362.59	86.14
Gjithsej	3921.34	100.00



Harta 6. Strukturat hapësinore në ZIV “SHP UÇK Kleçkë dhe Divjakë” (IPH)

2.3. Trashëgimia natyrore

Në këtë zonë janë të pranishme lokacionet e mbuluara me pyje dhe kullosa, të cilat japin një pamje shumë tërheqëse dhe shërbejnë si vende për strehimin e faunës. Po ashtu kjo pjesë karakterizohet me prezencën e monumentit natyror me karakter gjeomorfologjik i ashtuquajtur Guri i Gradinës që i jep zonës pamje mjaft atraktive.

Guri i Gradinës është monument natyror i cili arrin lartësinë 30 m, shtrihet në një sipërfaqe rreth 2 hektar, në pjesën jug-lindore të fshatit Llapushnikë (komuna e Drenasit) në vendin e quajtur Gradinë, me lartësi mbidetare 976 m. Guri i Gradinës si monument natyrorë ka vlera unike shkencore, kulturo-historike turistike, gjeomorfologjike, gjeologjike dhe arkeologjike, vlerat natyrore të tij nuk janë të dëmtuara në shkallë të gjerë me përjashtim të prerjeve ilegale të drunjtëve në këtë hapësirë.¹

Në zonën përreth në të gjitha ekspozicionet është prezentë fitocenoza Fagetum Montanum me rreth 47 lloje që kanë një shtrirje mjaft të gjërë përreth monumentit. Kurse në aspektin

¹ Studim për mbrojtjen e vlerave të natyrës Guri i Gradinës si monument i natyrës – MMPH/ AKMM

faunistik, sipas të dhënave që posedon AKMM në këtë hapësirë hasen këto lloje shtazore: 8 lloje gjitarësh, ndërsa dy lloje të tjera të gjitarëve janë zhdukur, 9 lloje shpendësh, 4 lloje zvarranik, 2 lloje ujë tokësor.



Guri i Gradinës – monument natyror

3. Trashëgimia e Luftës së UÇK-ës


Duke u nisur nga rëndësia historike, politike dhe shoqërore e luftës çlirimtare të popullit shqiptar, të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe rëndësia shumëdimensionale e kësaj lufte, që arriti ta orientojë potencialin e vet ushtarak dhe politik në drejtimin e duhur, në drejtim të arritjes së lirisë, pavarësisë dhe demokracisë evropiane, shtohet domosdoja që këto vlera të pazëvendësueshme të popullit dhe të vendit tonë, të prezantohen, të ruhen dhe të kultivohen në formë dhe në trajtë institucionale dhe profesionale.

Vlerat kulmore të territorit që e përkufizon ZIV "SHP UÇK Kleçkë dhe Divjakë", janë të identifikuar me sakrificën dhe rezistencën e gjeneratave të hershme, që e kanë zhvilluar në kuadër të lokacioneve të ndryshme të kësaj zone. Në këtë aspekt, vlen të theksohet posaçërisht lokacioni në Divjakë (selia e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së), ku që nga fundvitet 80-ta kanë gjetur strehë udhëheqësit e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës, lëvizje kjo që organizoi dhe mbështeti demonstratat e vitit 1989 dhe më vonë ishte boshti kryesor i lëvizjes guerile, që kulmoi me themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, më vonë edhe me avancimin e saj në ushtri të organizuar në gjithë hapësirën e Kosovës.

Duke pasur për bazë vlerat e larta të trashëgimisë historike, hartimi i Planit Hapësinor të ZV „Kleçkë dhe Divjakë“, orientim themeltar do të ketë analizimin, vlerësimin dhe planifikimin e ruajtjes dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë historike, me theks të veçantë të vlerave sublime të luftës së UÇK-së në këtë zonë.

Theks i veçantë do t'i jepet prezantimit të sakrificës së luftëtarëve të lirisë në mbrojtje të popullatës civile, duke pasur për bazë faktin se në kuadër të zonës dhe në pjesët përreth saj, UÇK ka arritur të mbrojë dhe t'u krijojë kushte për jetesë rreth 80 mijë qytetarëve, që ishin strehuar nëpër male dhe gryka.

Në vazhdim në mënyrë të detajuar do të prezantohet gjendja e objekteve dhe zonave të cilat janë identifikuar si më kryesoret, në të cilat janë zhvilluar aktivitetet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostorong Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning



Instituti për Planifikim Hapësinor
Institut za Prostorno Planiranje
Institute for Spatial Planning

Trashëgimia e ZIV Kleçkë dhe Divjakë


Legjenda

<ul style="list-style-type: none"> Kufiri i zgjeruar sipas GP 1 Radio Kosova e Lirë - Berishë 2 Selia e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës - Novosellë 3 Shtabi i Përgjithshëm dhe Spitali Ushtarak i UÇK-së - Divjakë 	<ul style="list-style-type: none"> 4 Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së 5 Brigada 121 e UÇK-së "Ismet Jashari-Kumanova" - Kleçkë 6 Fshati i UÇK-së 7 Batalioni i III "Sadik Shala"-Luzhnicë
--	--


Harta 7. Trashëgimia e historike në ZIV “SHP UÇK Kleçkë dhe Divjakë” (IPH)

3.1. Zona Kleçkë - Shtabi i brigadës 121

Objekti ku janë zhvilluar aktivitetet e Shtabit të Brigada 121 është i dëmtuar përreth të cilit është një hapësirë e pa mbrojtur. Objekti është pronë private dhe është në shfrytëzim nga pronari i saj.



Harta 7. Trashëgimia e historike në “SHP UÇK Kleçkë dhe Divjakë” (IPH)



Shtabi i Brigades 121 të UÇK-së në ZIV Kleçkë dhe Divjakë

Legjenda

- 1 Selia e Shtabit të Brigadës 121
- 2 Objekti i Logjistikës
- 3 Depoja
- 4 Poligoni i ushtrimeve

Ortofoto 1. Shtabi i Brigadës 121 të UÇK-së ZIV

Në Kleçkë ka qenë selia e Shtabit të Brigadës 121 të UÇK-së “Ismet Jashari - Komandant Kumanova”. Në këtë lokacion ka vepruar edhe një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ku janë mbajtur takime të ndryshme të udhëheqësve të luftës me diplomatë evropianë dhe amerikanë.

Nga këtu për herë të parë në media televizive (për Televizionin Shqiptar) është deklaruar zëdhënësi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, z.Jakup Krasniqi.

Në lokacionin në Kleçkë, në pronën e familjes së Hafir Shalës, është bërë edhe xhirimi i Betimit të UÇK-së, që është transmetuar në të gjitha mediat botërore.



Selia e Shtabit të Brigadës 121



Ceremonia e Betimit të UÇK-së, Ismet Jashari –Kumanova - Kleçkë, Qershor 1998




Paraqitja e parë publike e zëdhënësit të UÇK-së Jakup Krasniqi

3.2. Zona Divjakë - Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së

Kjo zonë pas përfundimit të luftës është mirëmbajtur dhe është rrethuar me rrethoja nga shtylla betoni dhe teli. Është e mbrojtur edhe bërthama e objekteve që kanë shërbyer për Shtabin e Përgjithshëm. Në kuadër të kësaj zone janë:

1. Selia e Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së;
2. Objekt ushtarak;
3. Shërbimi për siguri;
4. Njësia speciale;
5. Pologoni i ushtrimeve.

Për shkak të pozitës së mirë gjeografike e cila gjendet në pjesën qendrore të maleve të Berishës, si dhe pozitës së mirë gjeostrategjike dhe ushtarake, në këtë zonë është vendosur Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Kjo Zonë ka pasur lidhje të mira komunikative me të gjitha brigadat brenda ZIV „Shtabi përgjithshëm Kleçkë-Divjakë” si dhe me zonat tjera operative që kanë vepruar në tërë Kosovën.



Ortofoto 2. Shtabi i përgjithshëm i UÇK-së

Një pjesë e fshatit Divjakë gjatë periudhës së luftës ka shërbyer si seli e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Në kuadër të tri objekteve ka vepruar Drejtoria Operative, Drejtoria e Shërbimit Informativ, dhe drejtoritë tjera të rëndësishme.

Në pjesën lindore të kësaj zone gjendet pjesa tjetër e vendbanimit, ku shtëpitë e tyre kanë shërbyer si spitale ushtarake, ku ka qenë e vendosur njësia speciale e Shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, si dhe furra e bukës e cila ka përgatitur ushqimin për njësitet e saj. Vlen të theksohet se në periudhën e fund viteve të 80-ta pikërisht ky lokacion ka shërbyer si vendqëndrim i udhëheqësve të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës. Kjo dëshmon

më së miri se njerëzit e sakrificës për lirinë e Kosovës, në Divjakë kanë gjetur strehim të sigurt.



Selia e SHP -UÇK-ës



Logjistika



Objekti ka shërbye për pushim



Objekti ka shërbye për siguri



Spitali Ushtarak




Parakalimi ushtarak dhe inspektimi i njësive ushtarake Divjakë Dhjetor 1998

Në këtë lokacion, ka aterruar për herë të parë, pas çlirimit të Kosovës, helikopteri i parë amerikan, që barte diplomatit e njohur amerikan, zëdhënësin e Departamentit të shtetit z. James Rubin. Pas luftës, lokacioni i fshatit Divjakë ku ka vepruar SHP i UÇK-së është shfrytëzuar për mbajtjen e takimeve të zgjeruara me diplomatë dhe ushtarakë ndërkombëtarë, të cilët kanë pasur rastin që të njihen për së afërmi me sakrificën e popullit të Kosovës.

3.3. Varrezat e dëshmorëve

Kjo zonë shtrihet në zonën kadastrale të Malishevës. Varrezat e dëshmorëve janë rregulluar dhe rrethuar e afër tyre është ngritur Lapidari madhështor me simbolikën e Portës së Lirisë. Këtu ka nevojë për një rregullim të mëtejshëm mjedisor, për sigurimin e ujit, për mirëmbajtje dhe ruajtje.



Harta 7. Trashëgimia e historike në ZIV “SHP UÇK Kleçkë dhe Divjakë”

Ortofoto 3. Varrezat e dëshmorëve të UÇK-së

Këtu gjenden varrezat e dëshmorëve të Brigadës 121 të UÇK-së “Ismet Jashari – Kumanova”, të rënë gjatë luftës në këto anë.



Lapidari i varrezave të dëshmorëve




Varrezat e dëshmorëve Kleçkë

Lokacioni ka vlerat kryesore historike që e identifikojnë tërë zonën, pasi këtu prehen të qetë eshtrat e heronjëve dhe dëshmorëve më të shquar të UÇK-së, që kanë luftuar për liri dhe e kanë mbrojtur popullatën civile si: Ismet Jashari-Komandant Kumanova, Agim Çelaj, Sadik

Shala, Ibrahim Mazreku dhe shumë e shumë luftëtarëve tjerë të lirisë. Ata janë simboli kryesor i ZIV “Kleçkë dhe Divjakë”.

3.4. Zona në Novoselë

Në Fshatin Novoselë si objekt i rëndësisë së veçantë (shtëpi private) është shtëpia ku ka vepruar “Selia e përkohshme e Qeverisë së Kosovës”, e cila gjatë vitit 1999 ka kryer funksionin dhe detyrat e saja. Këtu janë mbajtur takime të ndryshme të udhëheqësve të QPK-së me diplomatë të huaj, ku vlen të veçohet takimi i udhëheqësit të QPK-së dhe UÇK-së, Hashim Thaçi me diplomatën amerikan, zëdhënësin e Departmentit të shtetit, z. James Rubin.



Harta 7. Trashëgimia e historike në ZIV “SHP UÇK Kleçkë dhe Divjakë” (IPH)



Selia e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës në ZIV Kleçkë dhe Divjakë

Legjenda
 1 Selia e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës


Ortofoto 4. Selia e QPK

Objekti ku ka veprua Qeveria e përkohshme e R. Kosovës (Novoselë)



3.5. Radio Kosova e Lirë dhe Agjencia e lajmeve “Kosova Press” - shtëpia muze

Me 4 janar të vitit 1999, me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, në këtë zonë janë themeluar dy institucionet e para dhe të vetme informative të luftës – Radio “Kosova e lirë” dhe Agjencia e Lajmeve “Kosovapress”. Per shkak rëndësisë së madhe gjatë luftës çlirimtare që ka lujt ky institucion informativ si dhe ruajtjen e të gjitha mjeteve që janë përdorë në periudhën e luftës është ndërtuar shtëpia muze e Radio Kosova e lirë. Objekti është ndërtuar në vitin 2000-2001 në afërsi të lokacionit fillestar të “Radio Kosova e Lirë”.



Harta 7. Trashëgimia e historike në ZIV “SHP UÇK Kleçkë dhe Divjakë”



Ortofoto 5. Muzeu “Radio Kosova e lirë”

Në këtë objekt janë konservuar të gjitha pajisjet teknike të Radios Kosova e Lirë



Raportimi ne Radio Kosova e Lirë dhe bukeri ku është transmetuar Radio Kosova e Lirë, Janar 1999.




Arkiva “Kinoteka”



Mjetet e punës – “Kosova Press”

Veprimtaria e këtyre dy institucioneve informative është zhvilluar në fshatin Berishë, ndërsa në periudha të caktuara është zhvendosur në lokacionet përreth, pasi antena dhe teknika tjetër e transmetimit e radios dhe agjencisë me dhjetëra herë ka qenë cak i sulmeve ajrore të forcave serbe. Andaj sektori i informimit pranë SHP të UÇK-ës një pjesë të aktivitetit informativ e ka kryer në malin Pallanik në bunkerët e rregulluar enkas për Radio-Kosovën e Lirë.

Megjithëkëtë, punonjësit e këtyre dy institucioneve, me përkushtimin e tyre të lartë kombëtar dhe profesional, dhe me sakrificën e tyre kanë arritur që të mbajnë të informuar jo vetëm luftëtarët e lirisë, por edhe popullsinë civile anë e kënd Kosovës.



Pallanik ku ka funksionuar Radio Kosova e Lirë

Në afërsi të fshatit Berishë shtrihet “Guri i Gradinës”, monument i natyrës i karakterit geomorfologjik, kategoria e tretë. Duke pasur parasysh pozitën e tij strategjike, UÇK e ka përdorur këtë lartësi si pikë strategjike vrojtimi. Në tërësinë hapësinore të Maleve të Berishës ndodhen po ashtu strehimoret ku është strehuar popullata gjatë luftës.



Guri i Gradinës -pikë strategjike e UÇK-së



Bunker luftime – afërsi të Gurit të Gradinës

3.6. Luzhnica

Në bashkëpunim me të gjitha anëtarët e grupit punues dhe me sugjerimet e pjesëmarrësve të luftës është vendosur që në kuadër të objekteve me rëndësi të veçantë është identifikuar edhe objekti në Luzhnicë ku ka qen Bataljoni III, “Sadik Shala” ku ka vepru Komandant Kumanova




Komanda e batalionit III “Sadik Shala” gjatë ceremonisë së betimit




Selia e komandës së batalionit III, Sadik Shala

Në këtë lokacion ka pasur selinë edhe zëvendëskomandanti i Brigadës 121 – heroi i kombit, Ismet Jashari-Komandant Kumanova. Nga ky vend janë organizuar aksione të shumta luftarake të UÇK-së, të cilat kanë rezultuar me sukses të plotë. Në Luzhnicë është xhiruar nga ana e Televizionit Shqiptar, Betimi i luftëtarëve të lirisë dhe ushtrimet e ndryshme luftarake.



Harta 7. Trashëgimia e historike në ZIV “SHP UÇK Kleçkë dhe Divjakë”



Komanda e Batalionit III të UÇK-së në ZIV Kleçkë dhe Divjakë

Legjenda

- 1 Selia e Batalionit të III të UÇK-së “Sadik Shala”
- 2 Objekti i shfrytëzuar nga “Batalioni i III”
- 3 Istikamet

Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada-Government
 Ministria e Mbrojtjes dhe Transportit dhe Luftës
 Ministry of Defense and Spatial Planning

Instituti për Planifikim Hapësinor
 Institut za Prostorni Planiranje
 Institute for Spatial Planning

Ortofoto 6. Komanda e batalionit III- UÇK-Sadik Shala Luzhnicë

4. Popullsia dhe zhvillimi social

Popullsia është çelës i planifikimeve zhvillimore në territori të caktuar andaj, që të kemi planifikime sa më profesionale kërkohet numri dhe disa nga karakteristikat e popullsisë. Në mungesë të të dhënave të nevojshme është parë e udhës të realizohet një anketë/hulumtim ku përafërsisht do të identifikohet numri dhe disa nga karakteristikat e popullsisë së zonës në fjalë. Anketa është realizuar me banorët përkatësisht më përfaqësuesit dhe arsimtarët e vendbanimeve.

4.1. Numri i popullsisë

Rezultatet tregojnë se në këtë zonë jetojnë rreth 500 banorë, të shpërndarë në katër vendbanime Kleçkë, Divjakë, Novosellë dhe Berishë. Zona përfaqësohet me mbi 100 ekonomi familjare.

4.2. Dendësia e popullsisë

Në këtë zonë jetojnë jo më shumë se 15 banorë për 1 km². Është territor kodrinor-malor me lartësi mbidetare mbi 850 m.

4.3. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë

Kjo zonë ka popullsi në moshë të re. Në këtë zonë 26.7 % e popullsisë së përgjithshme përfaqësohet nga mosha 0 deri 18 vjeç, ndërkaq, grup-mosha 19 – 64 vjeç e përbën 70.1% të popullsisë dhe grup-mosha 65 vjeç e më shumë përfaqësohet me 3.2% të popullsisë së përgjithshme. Këto të dhëna më së miri tregojnë se kjo zonë si dhe i tërë territori i Kosovës, ka popullsi të re me 70% të saj në moshë pune. Sa i përket strukturës së popullsisë sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se gjinia mashkullore është e përfaqësuar me 56.4%, ndërkaq, gjinia femërore është e përfaqësuar me 43.6%. Këto të dhëna tregojnë se gjinia mashkullore dominon në këtë zonë, gjë që nuk i ngjan rezultateve të nivelit qendror sa i përket dallimeve gjinore.

4.4. Struktura etnike e popullsisë

Rezultatet e hulumtimit dhe të dhënave zyrtare të shfrytëzuara tregojnë se në këtë zonë përkatësia etnike është kompakte, pra zona është e banuar vetëm me shqiptarë.

4.5. Migrimet e popullsisë

Migrimet e popullsisë sot paraqesin një problem shumëdimensional hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik, ndërsa i nxisin një varg faktorësh të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar². Mungesa e të dhënave demografike në përgjithësi dhe për migrimet në veçanti, vështirëson punën dhe arritjen deri te rezultatet e sakta mbi migrimet për këtë zonë. Sipas vlerësimeve nga anketa vihet në pah se në këtë zonë kemi të bëjmë me migrime të popullsisë brenda territorit të Kosovës dhe emigrime të jashtme. Rezultatet tregojnë se rreth 20 familje kanë emigruar drejt vendeve të zhvilluara dhe rreth 30 familje të tjera për në vendbanime/qytete të tjera të Kosovës. Këto të dhëna tregojnë se 1/3 e familjeve kanë migruar që nga periudha e pasluftës '99. Shkaqet që i kanë kushtëzuar këto migrime janë të natyrave të ndryshme, duke përfshirë ato ekonomike dhe të punësimit (përmirësimi i kualitetit të jetës), sociale, etj. Shkaqet socio-ekonomike (punësimi) janë ndër shkaqet kryesor që i kanë kushtëzuar këto migrime, për faktin se shumica e popullsisë së zonës nuk kanë qenë të punësuar dhe si zgjidhje të vetme për të siguruar kushte më të mira për jetesë e kanë pasur migrimin.

4.6. Arsimi

Arsimimi është themeli i një shoqërie të shëndoshë, i cili garanton perspektivë për të ardhmen shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike të një vendi. Në sistemin arsimor të Kosovës pas vitit 2000 u bënë zhvillime të theksuara në realizimin e programeve mësimore

² Hivzi Islami, Studime Demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, Prishtinë 2008. fq. 255.

bashkëkohore dhe në përmirësimin e kushteve mësimore në përgjithësi. Në vitin 2002 u krijua një model i ri për sistemin arsimor në vend. Struktura e re ofron 5 vite të arsimit fillor, pasuar nga 4 vite të shkollimit të ultë të mesëm dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të lartë të mesëm. Modeli 5+4+3 po zëvendëson strukturën e mëparshme 8+4+4. Me strukturën e re, arsimi i obligueshëm është zgjatur për një vit nga 8 vjet sa ishte në 9 vjet.

Struktura organizative e sistemit arsimor në zonë përbëhet nga dy nivele: arsimi fillor (I - V), arsimi i mesëm të ulët (VI - IX). Numri i objekteve shkollore gjithsej është 1 (një) në fshatin Novoselë (1-9 klasë) dhe 1 (një) paralele në fshatin Kleçkë (1-4 klasë). Në procesin arsimor janë të përfshirë rreth 200 nxënës. Ndërkaq, të angazhuar në procesin mësimor janë 16 mësimsdhënës, 1 drejtor dhe 4 punëtorë teknik. Raporti nxënës-mësimsdhënës në këto hapësira shkollore sillet rreth 13 nxënës mesatarja për 1 mësimsdhënës. Sa i përket kushteve fizike të objekteve shkollore, mbizotëron një gjendje jo e mirë e objekteve shkollore sidomos në shkollën fillore/paralelen Kleçkë.

4.7. Shëndetësia

Shëndetësia kosovare edhe përkundër investimeve të mëdha të bëra pas vitit '99 ende lë për të dëshiruar. Aktualisht në Kosovë sistemi shëndetësor është i organizuar në tri nivele; a) niveli parësor b) dytësor dhe c) niveli tretësor. Përveç në sektorin publik, është i organizuar edhe në sektorin privat në një shkallë mjaftë të gjerë.

Në këtë zonë, shëndetësia është e organizuar në sektorin publik në nivelin parësor. Shërbimet mjekësore ofrohen vetëm në një objekt shëndetësor ku punon një teknik medicinal dhe dy herë në javë vizitohet nga mjeku familjar. Shtëpia e shëndetit ndodhet në fshatin Novoselë - Fshati i Ri, ku gravitojnë të gjitha vendbanimet e tjera për rreth. Sa i përket gjendjes fizike të objektit shëndetësor, ai nuk është në gjendje të dëshiruar. Gjendja e mirë shëndetësore është shumë e varur edhe nga faktorët mjedisor, në radhë të parë nga ajri, uji për pije, etj. Këto pasuri natyrore kanë bërë që popullata e kësaj ane të jetë e shëndoshë.


4.8. Papunësia dhe varfëria

Shkalla e lartë e papunësisë që si pasojë sjellë shkallën e lartë të varfërisë, janë një ndër sfidat dhe problemet që më së shumti e tangojnë popullatën e kësaj ane. Burimi kryesor i punësimit për popullatën e kësaj ane është sistemi arsimor ku janë të involvuar një numër shumë i vogël i të punësuarve dhe veprimtaria e përpunimit të gëlqeres e njohur nga kjo anë ku në periudha të shkurta kohore angazhohet një numër i konsiderueshëm i të punësuarve. Në këto vendbanime në bazë të anketës së realizuar, mbi 80% e popullsisë llogariten si të papunë ose të punësuar sezonal. Burimi kryesor të ardhurave e kanë kurbetin, ku ende nga ato mjete arrijnë të mbajnë familjet e tyre sa do të pasigurta që janë ato mjete.

Natyrshëm, zona e largët nga vendbanimet urbane, zona kodrinore-malore me lartësi të madhe mbidetare, me shkallë të ulët të arsimimit, me shëndetësi të pazhvilluar, me kushte jo të mira banimi etj, janë të përfshira nga shkalla më e lartë e papunësisë dhe varfërisë.

Fëmijët e zonës






Harta 8. Shkollat dhe ambulanta në ZIV “SHP UÇK Kleçkë dhe Divjakë”

5. Infrastruktura

5.1. Infrastruktura e transportit

Në vitet e fundit është punuar shumë në asfaltimin e rrugëve në ZIV „SHP UÇK Kleçkë dhe Divjakë. Rruga e asfaltuar i lidhë fshatrat e kësaj zone që janë Kleçka, Divjaka, Novosela dhe Berisha. Shtëpitë në Divjakë janë pak më larg nga kjo rrugë se sa shtëpitë e fshatrave tjerë. Mungojnë rrugët e asfaltuara që do ta lidhnin brendinë (lagjet në brendi të fshatrave) e këtyre fshatrave me rrugën e asfaltuar. Në Zonë janë gjithsej 16.5 km rrugë të asfaltuara. Lidhshmëria rrugore e ZIV me rrugët nacionale dhe regjionale është e mirë. Me rrugën M25 Prishtinë-Prizren zona lidhet në Carralëvë dhe te Qafa e Duhles, me rrugën M9 Prishtinë-Pejë lidhet në Komoran, me rrugën R110 Malishevë-Arllat lidhet në Tërpezë e po ashtu zona lidhet edhe me rrugën R120 Lipjan-Sllatinë.



Harta 9. Infrastruktura rrugore në ZIV “ SHP UÇK Kleçkë dhe Divjakë”

5.2. Infrastruktura e telekomunikacionit

Në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” nuk ka rrjet të telefonisë fikse, ndërkaq valët e telefonisë mobile të dy operatorëve më të mëdhenj në Kosovë Vala dhe Ipko e mbulojnë në tërësi këtë zonë. Po ashtu zona është e mbuluar në tërësi nga signali i tre televizioneve kombëtare RTK, RTV 21 dhe KTV.

5.3. Infrastruktura e energjetikës

Furnizimi me energji elektrike i ndërtesave të pakta që janë në ZIV „SHP.UÇK. Kleçkë dhe Divjakë” është i rregullt. Zona me energji elektrike furnizohet nga TS 35/10 kV Drenasi me anë të largpërçuesit (LP) 10 kV. Ky largpërçues kalon afër zonës. Linja e LP 10 kV kryesisht përbëhet nga shtyllat e drurit 12 m dhe në një pjesë të vogël edhe nga shtyllat e betonit 12 m. Në izolatorë 12 kV (pjesërisht në disa pjesë të linjës edhe izolatorë 24 kV) janë shtrirë përçues Al-Fe 3 x 25 mm² dhe Al-Fe 3 x 35 mm². Disa zona janë të përfshira edhe me rrjetin distributiv të energjisë elektrike 0.4 kV, gjegjësisht me trafostacionet 10/0.4 kV. Linjat distributive 0.4 kV përbëhen zakonisht nga shtyllat e drurit 9 m ku në izolatorë 1 kV janë shtrirë kryesisht përçues Al-Fe 3 x 25 mm² dhe Al-Fe 3 x 35 mm². Trafostacionet janë në shtylla hekuri me transformatorë energjetik me fuqi prej 100 kVA deri 250 kVA.

5.4. Infrastruktura ujore

Në zonë nuk ka të instaluar sisteme të ujësjellësit dhe kanalizimit të ujërave të zeza. Uji sigurohet nga burimet nëntokësore.

6. Kleçka dhe Divjaka në kontekst ekonomik

Dy zonat apo dhe komunat të cilave ju takojnë ZIV, në aspektin e zhvillimit ekonomik, hyjnë në radhën e komunave më të pazhvilluara të Kosovës, dhe një nga zonat më të dëmtuara nga lufta e fundit 99'. Pothuajse e gjithë ekonomia e këtyre komunave është e koncentruar në bujqësi. Në zonën e interesit të veçantë, nuk ekziston kurrfarë industrie dhe tregtie e trashëguar nga periudha e paraluftës. Aktivitetet prodhuese zhvillohen kryesisht përmes ekonomive familjare, të cilat janë të shpërndara nëpër lokalitete të ndryshme jashtë territorit të zonës, përderisa veprimtaritë tregtare shërbyese gjinden jashtë zonës nëpër vendbanimet e afërta. Zona e interesit të veçantë është zonë kodrinore-malore e pasur me faunë. Pyjet kanë qenë dhe janë të përshtatshme për gjueti turistike si pylli i Lipovicës (Blinajës) dhe Kleçkës, të cilat janë jo larg Lypjanit. Kjo zonë para viteve 99' është njohur si zonë për gjueti, në të cilën kanë ardhur për gjueti nga të gjitha viset e ish Jugosllavisë. Shumë vendbanime të Malishevës kanë hyrë në histori si arenë të fushëbetëve më të përgjakshmes siç janë Lacroci dhe Seniku dhe të cilat janë potencial i ardhshëm për turizëm historik.

Pyjet në zonë



7. Analiza e gjendjes - SWOT

Përparësitë	Mundësitë
Popullsi në moshë të re Infrastruktura e përshtatshme rrugore Mjedis relativisht i pastër Pozita e përshtatshme gjeografike Kushtet e përshtatshme për zhvillim të blegtorisë Prania e objekteve historike Zonë me vlera historike	Mundësi e zhvillimit të turizmit kulturo-historik, rekreativ Mundësi e zhvillimit të eko-turizmit Zhvillimi i blegtorisë Përmirësimi i gjendjes sociale (arsim, shëndetësi, punësim, etj)
Dobësitë	Rreziqet
Mungesa e Planeve Rregulluese për zonat me vlera historike Mungesa e menaxhimit ndaj objekteve me vlera historike Gjendja jo e mirë e objekteve sociale Shkalla e lartë e papunësisë Niveli i ulët i arsimit Shfrytëzimi i pakontrolluar i pyjeve Mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit	Zhdukja e dëshmimeve historike Shpërngulja-migrimi i popullsisë

8. Vlerësimi i kapaciteteve investive për ZIV "SHP. UÇK. Kleçkë- Divjakë"

Vlerësimi i kapaciteteve investive është hulumtim i potencialit dhe burimeve të mundshme për financimin e planeve zhvillimore për një territor të përcaktuar për zhvillim. Rezultatet e këtyre analizave duhet përdoren si bazë e të dhënave, që do të mundësojnë identifikimin e mundësive në territorin përkatës. Duke u bazuar në këto mundësi, krijohet një pasqyrë reale e përzgjedhjes së projekteve që do të jenë specifike për zonën. Kapacitet investive mund të jenë nga: sektori publik, sektori privat, partneriteti publiko - privat, kreditë dhe grantet, donacionet, etj.

Investimet e realizuara dhe të planifikuara për ZIV "SHP. UÇK. Kleçkë- Divjakë"

Në bazë të informatave momentale po paraqesim një pasqyrë të investimeve të realizuara dhe të planifikuara për zonën në fjalë.

Investimet e realizuar deri në vitin 2010 në ZIV ku administrojnë Komuna e Lipjanit janë realizuar gjithsej investime me vlerë 67,460.00 €, duke përfshirë rregullimin e varrezave të dëshmorëve me vlerë 51.500.00 € dhe meremetimin e segmentit rrugor Baicë - Divjakë me vlerë 15.960.00 €

Investimet e realizuar deri në vitin 2010 në ZIV nga niveli Qendrorë sipas informatave momentale kapin vlerën prej 11,691,075.39 € ku përfshihet ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Magurë - Shalë - Kleçkë; Ndërtimi i rrugës Magurë - Shalë - Kleçkë (faza II); Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës Tërpezë - Kleçkë; dhe ndërtimi i rrugës Kleçkë -Qafa e Dulës;

Tabela 1 - Investime të realizuara deri në vitin 2010

Nr	Emri i projektit	Burimi financiar	Vlera në €
1	Rregullimi i Varrezave të dëshmorëve të UCK-së	KK Lipjan	51,500.00 €.
2	Meremetimi i segmentit rrugor Baicë - Divjkë	KK Lipjan	15,960.00 €
3	Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës Magurë - Shalë - Kleçkë	Niveli Qendrorë	1,142,132.40 €
4	Ndërtimi i rrugës Magurë - Shalë - Kleçkë (fazë II)	Niveli Qendrorë	6,836,256.91 €
5	Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës Tërpezë - Kleçkë	Niveli Qendrorë	514,330.06 €
6	Ndërtimi i rrugës Kleçkë -Qafa e Dulës	Niveli Qendrorë	3,198,356.02 €
Gjithsej investime të realizuara			11,758,535.39 €

Tabela 2 - Investimet e planifikuara për vitin 2011 +

Nr	Emri i projektit	Burimi financiar	Vlera në €
1	Implementimi i rrjetit rrugorë në vendbanimin Kleçkë	KK Lipjanë	15.960.00 €
2	Hartimi i planeve rregulluese për zonat e identifikuar me PH ne ZIV "Kleq - Divjkë"	Niveli Qendrorë	Rreth 120.000.00€
Gjithsej investime të planifikuara			Rreth 140,000.00€

9. Sfidat e zhvillimit hapësinor të zonës

9.1. Zhvillimi dhe promovimi i vlerave historike-kulturore në Zonë

Si të zhvillohen dhe promovohen vlerat e luftës, përmes objekteve që kanë pasur një rëndësi më të madhe historike, të gjitha këto në dobi të zhvillimit ekonomik të vendit?

Trashëgimia kulturore është pasuri e përgjithshme, që duhet të shfrytëzohet dhe mbrohet nga të gjithë, të trashëgohet nga ne dhe gjeneratat e ardhshme. Në bazë të koncepteve themelore të UNESCO-s secili element, monument apo tërësi e trashëgimisë kulturore dhe natyrore është unike dhe zhdukja e cilitdo prej tyre përbën humbje definitive dhe të pakthyeshme të trashëgimisë.

Trashëgimia kulturore dhe natyrore jep një ndjenjë identiteti dhe ndihmon në dallimin e kulturave të ndryshme fetare në klimën e globalizimit, u mundëson të njohin dhe kuptojnë njëri-tjetrin, dhe njëkohësisht përbën një pasuri të rëndësishme zhvillimi. Prandaj, kjo ide mbrohet me forcë nga Këshilli i Evropës sipas së cilës të gjithë anëtarët e BE-së i japin rëndësi të veçantë mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë së tyre kulturore në bazë të standarde të përvetësuara nga BE. Një situatë e tillë na jep të kuptojmë që edhe Kosova duhet të bëjë përpjekje për përmbushjen e këtyre standardeve me qëllim të integritetit në familjen evropiane.

Rregullimi i planifikimit hapësinor duhet të ketë parasysh respektimin e këtyre parimeve ndërkombëtare:

1. Promovimi e interesave të përbashkëta të vendit duke mbrojtur resurset natyrore dhe kulturore, të mbështetur në zhvillim të qëndrueshëm;
2. Përparimi i trashëgimisë kulturore si faktor për zhvillim, mbrojtja e trashëgimisë kulturore si pjesë integrale e zhvillimit të shoqërisë, pasuritë kulturore trajtohen si potencial i zhvillimit të zonës në të cilën gjenden, në aspektin e zhvillimit ekonomik;
3. Zhvillimi dhe konservimi i TK dhe TN përmes një menaxhimi të matur. Me këtë do të ruhet dhe mbrohet thellimi i identiteteve regjionale dhe ruajtjes së llojllojshmërisë natyrore dhe kulturore të qyteteve dhe zonave rurale të një vendi.

Në përgjithësi në Kosovë, trashëgimia kulturore dhe natyrore konsiderohet si pasuri e vendit që shpreh identitetin e shoqërisë, e cila fatkeqësisht po kërcënohet çdo ditë e më shumë nga shkatërrimi. Në veçanti në zonën e "SHP-Kleçkë dhe Divjakë" është një numër i konsiderueshëm i objekteve me rëndësi historike, të cilat i janë nënshtruar rrezikut nga shkatërrimi i tërësishëm. Mirëmbajtja joadekuate dhe trajtimi i tyre momental është në kundërshtim me standardet themelore, prandaj ky element konsiderohet si njëri ndër faktorët kryesor me ndikim në uljen e vlerave të objekteve përkatëse.

Një element tjetër ndikues janë edhe ndërtimet e pakontrolluara që po ndodhin në afërsi dhe përreth zonave të dëshmuara kulturore dhe historike. Ndërtimi i tyre po ndikon në prishjen e strukturës së objekteve në veçanti dhe humbjes së pejsazhit që dëshmon zhvillimin e ngjarjeve dhe aktivitetet nga periudha e luftës.

Lista e çështjeve të identifikuar:

- Shkatërrimi i objekteve me rëndësi historike dhe rreziku nga zhdukja e tërësishme e tyre;
- Mos ruajtja e identitetit të objekteve dhe pejsazhit që dëshmojnë të kaluarën historike;
- Ndërtimet e paplanifikuara që rezultojnë me humbje të traditës së tërësive historike të zonave të identifikuar;
- Trajtimi joadekuat i objekteve dhe zonave që dëshmojnë të kaluarën historike;

Cilat janë veprimet dhe mundësitë e identifikuar?

- Përgatitja e listës së objekteve me rëndësi historike dhe inventarizimi i tyre;

- Propozimi i objekteve historike MKRS-së, për përfshirjen në kategori të caktuar në listën e bazës së të dhënave të monumenteve me trashëgimi kulturore;
- Hartimi i Planit Rregullues Urban, që rregullon dhe parasheh zhvillimet hapësinore për zonat e propozuara në kuadër të Zonës së Interesit të Veçantë “SHP. UÇK Kleçkë dhe Divjakë”;
- Promovimi i vlerave kulturore-historike që do të ndikojnë në ngritjen e vetëdijes për ruajtjen dhe trajtimin adekuatë të objekteve dhe hapësirave në kuadër të Zonës së Veçantë “SHP-Kleçkë dhe Divjakë”;
- Respektimi i legjislacionit të duhur;
- Respektimi i Konventave Evropiane që kanë të bëjnë me trashëgimi arkitekturore dhe arkeologjike, si dhe Konventat Evropiane që prekin fushën e mjedisit;

Të gjitha këto elemente të cekura më lartë mundësojnë realizimin e qëllimit kryesor “Mbrotjtja nga degradimi i vazhdueshëm i trashëgimisë kulturore”

9.2. Mbrotjtja dhe ruajtja e vlerave natyrore të zonës

Momentalisht ballafaqimi me çështje që kanë të bëjnë me mjedisin është njëra ndër sfidat kryesore në shoqërinë kosovare. Zhvillimet që po ndodhin në hapësirë, pjesa më e madhe e tyre, janë në kundërshtim edhe me normat dhe standardet mjedisore. Mungesa e planeve hapësinore dhe të menaxhimit, në nivelin qendror dhe posaçërisht në atë lokal, pastaj aktivitetet e pakontrolluara individuale ose kolektive, në të shumtën e rasteve kanë ndikim negativ në zonat me vlera natyrore.

ZIV „SHP. UÇK. Kleçkë – Divjakë” është territor që përmban pjesë të mbuluara me pyje, kullosa, livadhe dhe peizazhe natyrore mjaft atraktive. Brenda kësaj zone gjendet edhe monumenti (i kategorisë së tretë sipas IUCN-it) me vlerë të veçantë natyrore “Guri i Gradinës”, me karakter gjeomorfologjie i gërshetuar edhe me vlerat karakteristike për rajonin si të peizazhit natyror ashtu edhe të larmisë biologjike (botës së gjallë bimore e shtazore). Në përgjithësi, vet fakti se kemi të bëjmë me tërësinë e mbrojtur, me vlera natyrore në bashkërendim me ato kulturo-historike brenda saj, është gjë sfiduese sikur edhe mundësitë dhe mënyra e zhvillimit dhe promovimit të tyre. Sfidë më vete paraqet Monumenti Natyror “Guri i Gradinës”, që është territor me shumë vlera dhe veçori specifike natyrore (të rarisë, reprezentatives, rekreative, estetikes etj) si dhe vlerave të posaçme kulturore. Duke patur parasysh mundësinë e rrezikimit të kësaj pasurie nga faktorët natyror dhe antropogjen, me të drejtë mund të parashtrihen pyetjet: A ka nevojë për veprime parandaluese dhe paraprake në përkujdesje të veçantë ndaj vlerave? Cilat janë dhe si mund të koordinohen veprimet, për një mbrotjtje dhe ruajtje nga dëmtimi, ndotja dhe degradimi i vlerave? A kërkohet dhe a ka nevojë për një menaxhim efikas, më të organizuar të zonës dhe me përgjegjësi të ndara? A është e siguruar qasja në zonë dhe deri afër monumentit natyror? Si qëndron qasja në infrastrukturë dhe shërbime dhe a mund të përmirësohet gjendja e tyre për nevoja të vizitorëve dhe të popullsisë vendase për pritjen e tyre .

Konteksti

Fillimisht dhe në përgjithësi, për tërësinë hapësinore të kësaj zone, me vlera natyrore si dhe ato kulturo – historike, i nevojitet një menaxhim efikas, jo vetëm në mbrotjtje, ruajtje, por njëkohësisht edhe në përparim të mëtejshëm si dhe promovim të tyre. Menaxhimi i kërkuar bëhet me qëllim të plotësimit të nevojave të ndryshme, në mënyrë që vizitorëve të ju mundësohet përjetimi i këtyre vlerave, ndërsa popullsisë nikoqire ju mundësohet pritja, qëndrimi dhe përcjellja e tyre.

Larmia biologjike (Biodiversiteti) që është mjaft e shpërndarë në zonë, duhet ruajtur me kujdes nga dëmtimi apo degradimi i llojeve apo specieve (të botës bimore e shtazore) dhe të ndalohet rrezikimi i tyre e sidomos atyre të rralla, ndërsa gjuetia mund të zhvillohet vetëm në zonat e caktuara me specie të shpeshta dhe dëmtuese për mjedisin.

Ndër fatkeqësitë natyrore, që mund të rrezikojë vlerat njerëzore të krijuara dhe ato natyrore, mund të përmendim erozionin dhe zjarret, nga të cilët duhet pasur kujdes, si në mbrojtjen e vlerave ashtu edhe në parandalimin e të shkaktuarit të këtyre fenomeneve.

Shikuar nga aspekti i ndotjes së mjedisit, mund të thuhet se ajri dhe kapaciteti i vogël i ujit janë të pastër në masë të kënaqshme sa i përket zhvillimit industrial apo ndikimit negativ ekonomik. Mirëpo, aktivitetet tjera si nga hedhja e mbeturinave, djegia e gomave në furrat private për pjekje të gëlqeres, gurëthyesit, prerja e pakontrolluar e pyjeve, derdhja e ujërave të zeza në lumenj etj, që janë prezentë në zonë, mund të ndikojnë në ndotjen dhe degradimin e mjedisit.

Shfrytëzimi i resurseve natyrore, sidomos të bimëve dhe fryteve malore ashtu edhe të kullosave dhe livadheve, mund të ndikojë në zhvillimin rural të zonës me ngritjen e kapaciteteve të prodhimeve ekologjike si: prodhime të ndryshme blegtorale, të mjalitit, bimëve shëruese, etj.

Qasja në infrastrukturë dhe shërbime, qofshin teknike apo sociale, si për nevoja të popullsisë së brendshme ashtu edhe për vizitorët jashtë zonës, duhet ngritur me kujdes duke mos dëmtuar apo degraduar vlerat natyrore.

Çështjet e identifikuara

Në mënyrë që ky të jetë një mjedis çfarë dëshirohet, nevojitet të ndërmerren masa, të realizohen aktivitete ose projekte, të cilat vënë nën mbrojtje, ruajnë dhe promovojnë vlerat natyrore dhe kulturo - historike të zonës. Këto aktivitete janë:

- Menaxhimi brenda kufirit të saktë të zonës dhe koordinimi i veprimeve në përkujdesje dhe promovim të vlerave të saj.
- Përkujdesja ndaj biodiversitetit dhe zhvillimi i vlerave të mbrojtura me tërësinë e tyre;
- Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore (erozioni, zjarri, etj) dhe parandalimi i tyre;
- Ndalimi i dëmtimit të monumenteve dhe i ndotjes së mjedisit nga veprimtaria individuale apo kolektive;
- Qasja në infrastrukturë dhe shërbime;
- Shfrytëzimi i resurseve potenciale natyrore për zhvillim të turizmit rural

9.3. Zhvillimi socio-ekonomik në zonë

Pse dhe cka është sfiduese në aspekt të zhvillimit socio ekonomik në ZIV „SHP- Kleçkës dhe Divjakës“?

Aspekti social – Për këtë zonë, sfidë është zhvillimi i edukimit dhe arsimimit të të rinjve në hap me trendët të cilat po ndodhin në hapësirat tjera përkatësisht në ato urbane. Duke pasur parasysh kushte jo të mira sa i përket shkollimit dhe aspekteve të tjerë sociale, ekziston mundësia edhe më e madhe e shpërnguljes-migrimit të popullsisë nga kjo trevë.

Aspekti ekonomik – ZIV „SHP. UÇK. Kleçkë dhe Divjakë“ është zonë e ngërthyer me veçori historike në të cilën ka dhe veçori tjera të zonës rurale të cilat me vetë faktin e shpalljes së zonës së veçantë do të duhej po ashtu të kihen në konsideratë, dhe të elaborohen në kuptim të zhvillimit rural prej të cilit do të varen vendbanimet brenda zonës dhe amvisnit. Pra është sfidues zhvillimi i dëshiruar, i planifikuar dhe i qëndrueshëm rural kundrejt zhvillimit të zonës së veçantë me specifikat e veta që në këtë rast nuk guxojnë të bien ndesh, por të përkrahin dhe forcojnë më shumë njëri tjetrin. Sa i përket aspektit ekonomik, në zonën e veçantë në fjalë sfidues është zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë dhe infrastrukturës fizike.

Zgjidhjet në kuptim të ngushtë të zonës - Territori të cilin e përfshin ZIV është kryesisht zonë kodrinore e malore me vendbanimet e përfshira, duhet të planifikohet në kuptim të zhvillimeve rurale duke marrë parasysh veçantitë historike të tij. Në suaza të ngushta, kjo

zonë duhet të ofrojë mundësi për banorët e zonës, jetesë komode dhe veprimtari, si edhe më parë, për ekonomi familjare, por edhe mundësi të reja, të ofrojnë kapacitete për turizëm rural.

Zgjidhjet në kuptim të gjerë të zonës - Zona e interesit të veçantë „SHP.UÇK. Kleçkë dhe Divjakë” do të jetë edhe një vatër kulturore prej të cilës do të përfitojnë banorët, vizitorët dhe në fund e gjithë Kosova. Qeveria qendrore dhe ajo lokale duhet të mbështesë financiarisht resurset natyrore, të ndërhuara dhe ato njerëzore në dhe rreth zonës, konkretisht amvisnit në ngritjen e kapaciteteve të reja për blegtori, kapaciteteve për banim, në ofrimin e shërbimeve tjera për turizëm fshatar dhe në prodhimtarinë ekologjike, nga e cila do të përfitojë jo vetëm e gjithë zona porse dhe vendi. Duhet të mendohet në kombinime, bashkë dyzime të veprimtarive siç janë psh ajo e turizmit historik me atë fshatar dhe ekologjik që sot janë trend në botë si dhe kombinime tjera inventive.

Infrastruktura fizike - Pjesë e zhvillimit socio-ekonomik në zonë si një sfidë me të cilën do të ballafaqohemi, është edhe zhvillimi i infrastrukturës fizike. Arritja e një zhvillimi të dëshirueshëm të infrastrukturës fizike do të kontribuonte dukshëm në tejkalimin e sfidës. Për këtë arsye përpjekjet duhet të orientohen në sigurimin e qasjes përmes rrugëve të asfaltuara në të gjitha vendbanimet e Zonës dhe sigurimin e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm të gjitha këtyre vendbanimeve. Zhvillimi infrastrukturor i ndonjë zone rurale si ky për të cilin është fjala, nuk do të kishte paraqitur ndonjë sfidë për ndonjë vend të zhvilluar, por për Kosovën si vend me një nivel dukshëm më të ultë të zhvillimit socio-ekonomik, se sa të vendeve të zhvilluara e me mundësi të vogla investive, ky zhvillim paraqet sfidë aq më tepër kur realiteti në Kosovë tregon se përparësi për zhvillim socio-ekonomik po u jepet zonave urbane (veçanërisht Prishtinës). Plani hapësinor i ZIV „SHP. UÇK. Kleçkë dhe Divjakë” do të përcaktojë objektivat e qarta zhvillimore për Zonën dhe strategjinë për arritjen e tyre.

II VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

2. Deklarata e Vizionit

Park historik-kulturor dhe me vlera natyrore, i përkujtimit të luftës së popullit për çlirim, në shërbim të edukimit, promovimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

2.1. Parimet E Përgjithshme Për Zhvillim Dhe Mbrojtje

Parimet e përgjithshme bazohen në dokumentet të rëndësishme për planifikim hapësinor:

- Ligji për Planifikim Hapësinor 2003/14 dhe Ligji L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor;
- Parimet Udhëzuese për Zhvillimin e Qëndrueshëm Hapësinor të BE - ESDP³;
- Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm -Agjenda 21⁴;
- Parimet e qeverisjes së mirë urbane - Agjenda e Habitatit⁵

Parimet bazë mbi të cilat do të fokusohen zhvillimet e përgjithshme në raport me parimet ndërkombëtare janë:

- Promovimin e interesave të përbashkëta të komunës duke mbrojtur dhe zhvilluar resurset natyrore dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm.
- Promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes dhe përfshirjes në formulimin e strategjive zhvillimore dhe planeve fizike.
- Promovimin e transparencës së plotë në planifikim dhe procesin e marrjes së vendimeve duke iu lejuar pjesëmarrësve qasjen në të dhëna dhe hartat e nevojshme.
- Promovimin e të drejtave të barabarta ekonomike dhe shoqërore për të gjithë kosovarët.
- Promovimin e kualitetit të përmirësuar të jetës dhe forma të balancuara të vendbanimeve.
- Promovimin e harmonizimit me parimet dhe planet e vazhdueshme të zhvillimit hapësinor Evropian.

Parimet e qeverisjes së mirë

- **Qëndrueshmëria** - të ketë qasje të integruar e cila përfshin elementet hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunë.

³ Dokument i perspektivës Evropiane për zhvillim hapësinor, me parimet që shtetet anëtare duhet rregulluar: i) Kohезioni Ekonomik dhe Social; ii) Konservimi i resurseve natyrore dhe trashëgimisë kulturore dhe iii) Konkurenca e balancuar në territorin e Evropës.

⁴ Definicion për zhvillim të qëndrueshëm sipas "Our Common Future, 1987 United Nations World Commission on Environment and Development": "Zhvillim i cili i përmbush nevojat e të sotmes duke mos pamundësuar aftësitë për generatat e ardhëshme për arritjen e nevojave të tyre".

⁵ Parimet e Agjendës së Habitatit me qëllimet dhe parimet, zotimet dhe planin e përgjithshëm të veprimit për zhvillim të qëndrueshëm.

- **Subsidiariteti** – marrja e vendimeve mbi baza të hierarkisë nga niveli qendror në atë lokal dhe zbatimi sa më efikas.
- **Barazia** - plani duhet të merr parasysh aspektet e barazisë: minoritetet, femrat, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara (adresimi i nevojave të grupeve të tilla përmes pjesëmarrjes publike) të ketë në konsideratë aspektet e ndjeshmërisë gjinore.
- **Efikasiteti** - ti prijë zhvillimit strategjik në territorin e komunës dhe të trajtojë çështjet e rëndësishme strategjike për fushat përkatëse.
- **Transparenca** – të gjitha zhvillimet të cilat ndodhin në hapësirë duhet të kenë arsyen, dhe personat përgjegjës duhet të jenë transparent për zhvillimet në hapësirë.
- **Pjesëmarrja** – në këtë rast plani zhvillimor dhe urban si dy projekte shumë të rëndësishme për të ardhmen e komunës duhet të përfshijnë pjesëmarrje të gjerë me qëllim të përfaqësimit të interesave të të gjithëve pa dallime.
- **Përgjegjshmëria** – për të gjitha zhvillimet të cilat ndodhin në hapësirë duhet të jemi të përgjegjshëm. Këtë duhet ta bëjë si sektori publik, privat dhe deri te qytetari më i thjeshtë.

2.2. Synimet Dhe Objektivat

Synimi 1 - Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i vlerave historike-kulturore të parkut

- S1.O1. Edukimi, informimi dhe promovimi i vlerave historike, kulturore, natyrore dhe turistike për ZIV "SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë";
- S1.O2. Promovimi i parkut historik dhe kulturor ZIV, brenda dhe jashtë Kosovës;
- S1.O3. Bashkëpunimi i komunave në të cilat gjendet zona;
- S1.O4. Menaxhimi objekteve historiko-kulturore dhe natyrore të zonës;

Synimi 2 - Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i vlerave natyrore të parkut

- S2.O1. Mbrojtja e ajrit
- S2.O2. Mbrojtja e ujit
- S2.O3. Mbrojtja e tokës
- S2.O4. Mbrojtja e peizazhit, biodiversitetit dhe Monumenteve Natyrore brenda zonës

Synimi 3 - Zhvillimi rural

- S3.O1. Zhvillimi i turizmit fshatar- ekologjik
- S3.O2. Zhvillimi i blegtorisë, dhe bletarisë
- S3.O3. Ngritja e cilësisë në arsimim dhe shëndetësi;
- S3.O4. Sigurimi i qasjes përmes rrugëve në të gjitha objektet dhe monumentet e zonës dhe sigurimi i transportit publik;
- S3.O5. Sigurimi i furnizimit me energji elektrike;
- S3.O6. Ndërtimi i infrastrukturës ujore;
- S3.O7. Menaxhimi i mbeturinave

2.4. Prioritetet strategjike

- ✓ Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë historike - kulturore dhe mjedisit
- ✓ Zhvillimi i ekonomisë së qëndrueshme
- ✓ Zhvillimi i infrastrukturës fizike

III KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

3. Koncepti dhe Struktura e Zhvillimit Hapësinor

Zona e Interesit të Veçantë „SHP.UÇK.Kleçkë-Divjakë” ofron mundësi për zhvillim ekonomik vital dhe perspektivë për banorët e saj. Natyra e qetë e Maleve Berishë paraqet ambient të përshtatshëm për pushim dhe rekreacion, si dhe aktivitete tjera me karakter ekonomik. Në anën tjetër, pjesa e trashëgimisë së luftës ofron potencial dhe kushte të mira për sektorin e turizmit, zhvillimin e bizneseve në vendbanime dhe të infrastrukturës fizike. Pjesa më e madhe e zonës, ka perspektivë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike, ku dominon agrobiznesi (fermat) si dhe aktivitetet e tjera tregtare dhe shërbyese. Zona ofron kushte të konsiderueshme për banim, ku përveç rrugës kryesore me të cilën zona lidhet me rrjetin e rrugëve të Kosovës, ka një sasi të konsiderueshme të tokës bujqësore, të kullosave si dhe mundësi për zhvillimin e aktiviteteve tregtare dhe shërbyese.

Mbrojtja, zhvillimi dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe potencialeve të kësaj zone mundëson hapjen e perspektivave të reja për zhvillimin e zonës, me theks të veçantë në turizmin rural dhe atë të trashëgimisë kulturore-historike. Duke e pasur parasysh gjendjen e vështirë të vendbanimeve në zonë, propozohet favorizim dhe ofrim i shërbimeve të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së jetës duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve në arsim, ofrimin e shërbimeve adekuata mjekësore dhe infrastrukturën e nevojshme sociale-teknike. Kjo do të ndikonte në stabilizimin e migrimeve dhe rritjen e interesimit të popullsisë për të jetuar dhe punuar në fshat.

Si rezultat i analizave që janë bërë gjatë përpilimit të këtij plani hapësinor e duke u bazuar sidomos në gjendjen momentale të shfrytëzimit të tokës, ka dalur koncepti i shpërndarjes lineare të zhvillimeve hapësinore përgjatë korridorit rrugor të rrugës Duhël-Berishë që shoqërohet me shpërndarjen e barabartë të zhvillimeve edhe në pjesët e vendbanimeve që janë më larg kësaj rruge. Gjendja ekzistuese e shpërndarjes së zhvillimeve në hapësirë flet se numri më i madh i banorëve dhe i objekteve të banimit dhe shërbimeve sociale shtrihet përgjatë rrugës kryesore (fshatrat Berishë, Novoselë, Divjakë dhe Kleçkë), aktivitetet e pakta ekonomike kanë shtrirje lineare, si dhe pothuaj të gjitha përmbajtjet që dëshmojnë aktivitetet nga lufta e fundit shtrihen në mënyrë lineare përgjatë rrugës Kleçkë - Berishë. Ky koncept është bazuar në mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore-historike dhe natyrore, duke ofruar infrastrukturën e nevojshme dhe duke shtuar kontrollin e zhvillimit të banimit në drejtim të brendësisë së zonës. Sipas këtij koncepti, çështje e rëndësishme së veçantë do të jetë komunikimi dhe lëvizja në kuadër të gjithë zonës. Monumentet natyrore të zonës do të komunikojnë përmes shtigjeve të ecjes, ku do të mundësohet vizita dhe mundësia e përjetimit të peizazheve natyrore gjatë lëvizjes. Pika referuese e të gjithë zonës të jetë zona e “Lapidarit dhe varrezave të dëshmorëve”, e cila do të shërbejë edhe si qendër informuese për të gjitha përmbajtjet që ofron ZIV - „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” në tërësi.

Koncepti mundëson një zgjidhje të qëndrueshme dhe konsiston në:

1. Përkujdesjen dhe promovimin e objekteve historike-kulturore dhe natyrore, përmes zhvillimit të turizmit;
2. Promovimin e prodhimeve kualitative vendore - eko-turizmi;
3. Kontrollimin e rritjes së vendbanimeve në kuadër të zonës dhe lidhjen me fshatrat që janë jashtë zonës;
4. Fuqizimin e rrjetit rrugor që lidhet me fshatin Shalë në JL të zonës, në jug me fshatin Duhël, në perëndim me Malishevën dhe në veri me fshatin Tërpezë.

Koncepti i zhvillimit hapësinor në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” po ashtu konsiston në ndarjen e kësaj zone në tri zona më të vogla. Zonat janë:

1. Zona aktive – zona në të cilën kryesisht janë të shtrira vendbanimet dhe veprimtaritë sociale dhe ekonomike;
2. Zona e vlerave natyrore – zona që kryesisht përbëhet nga pyjet dhe kullosat dhe
3. Zona e vlerave të trashëgimisë kulturore-historike – zona që ka objekte dhe përmbajtje që dëshmojnë të kaluarën dhe aktivitetet luftarake që kanë ndodhur gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Këto zona dallojnë njëra nga tjetra në aspektin ekonomik, social dhe mjedisor.




Fig. 1. Koncepti i zhvillimit hapësinor ZIV “SHP. UÇK.Kleçkë dhe Divjakë”

3.1 Zona aktive

Kjo zonë shtrihet kryesisht në pjesën qendrore të ZIV më lartësi mbidetare mbi 900m. Ajo përfshinë pjesët fushore të zonës ku është koncentruar banimi, popullsia, shërbimet sociale dhe infrastruktura rrugore. Funksionet e kësaj zone janë: bujqësia, turizmi, tregtia, ekonomia e vogël dhe transporti.

Bujqësia - Zhvillimi i bujqësisë do të mundësojë kultivimin e kulturave bujqësore më profitabile duke zgjeruar sipërfaqet nën kultura të pemëtarisë si dhe zhvillimin e blegtorisë, bletarisë dhe shpezëtarisë.

Turizmi - Zhvillimi i vendbanimeve përgjatë akseve rrugore mundëson zhvillimin e veprimtarisë turistike të zonës si dhe shitjen e eko-prodhimeve. Turizmi që mund të zhvillohet në këtë zonë është kryesisht i llojit kulturor dhe peizazhor. Ndërtimet e kontrolluara të hoteleve, restoranteve dhe moteleve duhet të ofrojnë shërbime tradicionale dhe bashkëkohore për vizitorët. Hotelet, motelet, restorantet do të ofrojnë shërbime për nevojat e turizmit e po ashtu do të rrisin mundësinë për punësim dhe zhvillim ekonomik të komunës. Monumentet e trashëguara nga lufta e fundit e kanë vlerën e vet si atraksion turistik i Zonës. Peizazhi që ofron kjo zonë është mahnitës për faktin se nga cilado anë mund të shihen dy tërësi fushore të Rrafshit të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit.

Tregtia - Zhvillimi i tregtisë mbështetet në qasjen e mirë që e ka zona në rrjetin rrugor dhe linjat e transportit nacional. Tregtia do të zhvillohet për nevoja lokale dhe regjionale.

Ekonomia e vogël - Monitorimi i aktiviteteve të nxjerrjes së gurit gëlqeror është çështje e cila duhet të merret në konsideratë nga se kjo trajtohet si zeje tradicionale e banorëve lokal, mirëpo zhvillimi i kësaj veprimtarie duhet të vihet nën kontroll. Fillimisht do t'i kushtohet rëndësi e madhe mjedisit jetësor, pastaj edhe krijimit të mundësive për bizneset, pra edhe për aktivitetet sa i përket gëlqeres. Zonat të cilat deri tani janë eksploatuar duhet t'i nënshtrohen masave rehabilituese me qëllim të përmirësimit të mjedisit qoftë ai human apo natyror. Me zhvillim të zonës duhet që ne përjdh afat meseum të parandalohet persisht kjo veprimtari për shkak të ndotjes së mjedisit

Transporti - Momentalisht niveli i zhvillimit të transportit publik nuk është i kënaqshëm. Ai realizohet me furgonë privatë në intervale të rralla kohore, kurse transport me autobus nuk ka. Transporti mund të zhvillohet me investime jo shumë të mëdha, sepse parakushti për këtë zhvillim e që është ndërtimi i rrugës është plotësuar. Ndërtimi i rrugës së re ka bërë që qasja nga 5 komunat: Drenas, Lipjan, Malishevë, Therandë (Suharekë) dhe Shtime të jetë mjaft e përshtatshme.

3.2. Zona e vlerave natyrore

Pjesa më e madhe e territorit të ZIV shtrihet në këtë zonë. Zona është një hapësirë malore që karakterizohet me vlera të rëndësishme natyrore dhe për këtë arsye është quajtur zona e vlerave natyrore. Kjo zonë përfshinë rreth 3,500 ha ose 85% pyje dhe rreth 300 ha kulloso ose 8% nga sipërfaqja e përgjithshme e Zonës. Për shkak të veçorive fiziko-gjeografike, kjo zonë është e pasur me vlera natyrore të veçanta. Zona e vlerave natyrore është e pa banuar por ndikimet e faktorit njeri janë prezentë. Masat mbrojtëse për të cilat obligon Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës janë në funksion të zhvillimit të turizmit si dhe në funksion të mbrojtjes së natyrës. Mbrojtja e monumenteve natyrore kërkohet nga se vlerat e veçanta natyrore të tyre janë vlera të trashëguara me gjenerata të tëra dhe janë në funksion të zhvillimit të mëtejshëm si në aspektin mjedisor ashtu edhe në atë ekonomik. Monumenti më i rëndësishëm është Guri i Gradinës i cili është nën mbrojtje ligjore. Zhvillimi i turizmit këtu është në hapat e parë dhe kombinimi i vlerave natyrore dhe atyre të trashëgimisë kulturore-historike paraqet një potencial për zhvillimin e mëtejshëm të tij. Funksionet e kësaj zone janë: pylltaria, blegtoria, bletaria, turizmi, gjuetia dhe eksploatimi i resurseve natyrore.

Pylltaria - Pylltaria si aktivitet ekonomik kërkon trajtim jo vetëm si pasuri kombëtare por edhe si pasuri e komunave Drenas, Lypjan dhe Malishevë. Kapacitetet e kufizuara pyjore e bëjnë edhe më bindëse qëllimin për mbrojtjen e pyjeve nga prerja e pakontrolluar.

Blegtoria - Blegtoria dhe zhvillimi intensiv i saj duhet të jetë njëri ndër aktivitet shumë të rëndësishme në këtë zonë, bazuar kryesisht në potencialin e kullosave dhe livadheve të cilat i ka kjo zonë, si dhe në vlerën ekologjike të tyre, e cila i bën specifike. Kullosat kapin një fond toke prej rreth 300 ha dhe janë potencial serioz për zhvillimin e blegtorisë.

Bletaria - Bletaria ka në dispozicion të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillim në këtë zonë, andaj edhe investimi në këtë degë të bujqësisë do t'i ndihmojë zhvillimit të saj ekonomik dhe kulturor. Zhvillimi i bletarisë duhet të stimulohet, duhet të subvencionohen familjet të cilat dëshirojnë të merren më këtë veprimtari e cila është shumë profitabile dhe, si rrjedhojë, ka shumë mundësi të pengojë shpopullimin.

Turizmi - Turizmi malor dhe vikendor do të jenë llojet kryesore të turizmit në këtë zonë. Një ndër vlerat natyrore janë peizazhet e ndryshme të formuara nga kombinimi i pasurive pyjore, kullosave dhe formave gjemorfologjike të terrenit.

Gjuetia - Zhvillimi i gjuetisë së kontrolluar do të jetë një tjetër ndihmues në zhvillimin e kësaj treve. Gjuetia duhet t'i nënshtrohet regjimit të kontrollit dhe të monitorohet pa ndërprerje.

Ekspluatimi i resurseve natyrore - Sa i përket gëlqeroreve dhe ekspluatimit sipërfaqësor të mineraleve, duhet të bëhet licencimi i disa veprimtarive të cilat merren kryesisht me shfrytëzimin e shkëmbit ose të pezullohen ato. Fillimisht duhet të bëhet një vlerësim i ndikimit të tyre në mjedis dhe i ndikimit socio-ekonomik të tyre, e pastaj të merren vendime të caktuara me të cilat ato aktivitete do të legalizohen ose do të ndalohen.

3.3. Zona e vlerave të trashëgimisë kulturore-historike

Shpallja e pjesës nga Kleçka deri në Berishë si zonë e interesit të veçantë ka pasur për qëllim mbrojtjen, ruajtjen dhe shfrytëzimin e vlerave të trashëgimisë së luftës së UÇK-ës. Identifikimi dhe zoonimi i këtyre vlerave të trashëgimisë së luftës janë bazë e mirë e zhvillimit të zonës si në aspektin socio-ekonomik ashtu edhe në atë mjedisor. Në bazë të analizave të gjendjes ekzistuese, në kuadër të kësaj zone janë identifikuar 8 lokacione të trashëgimisë së luftës. Të gjitha këto pika janë lënë nën mëshirën e natyrës dhe pa përkujdesje, përjashtim në këtë aspekt bëjnë objekti i Radio Kosova e Lirë në Berishë dhe Varrezat e Dëshmorëve në Kleçkë në të cilat janë bërë investime paraprake.

Propozohet që nën mbrojtje institucionale të vihen këto objekte të trashëgimisë:

- Radio Kosova e Lirë (shtëpia Muze) dhe Agjencia e lajmeve "Kosova Press" Berishë
- Pika ku ka vepruar Radio Kosova e Lirë në Pallanik
- Shtëpia ku ka qëndruar Qeveria e Përkohshme e R. Kosovës në Novoselë
- Vendqëndrimi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së - Divjakë
- Spitalet, furrat e bukës, logjistika - Divjakë
- Varrezat e Dëshmorëve - Kleçkë
- Brigada 121 „Ismet Kumanova” - Kleçkë dhe
- Komanda e batalionit të tretë „Sadik Shala” - Lluzhnicë

IV STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

4.1. Mjedisi, Trashëgimia Natyrore, Historike dhe Kulturore

Në Zonën e Interesit të Veçantë „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” duhet të mbrohet dhe ruhet mjedisi e po ashtu të mbrohen, ruhen dhe zhvillohen vlerat natyrore, historike dhe kulturore. Në mënyrë që kjo të arrihet janë propozuar masa për mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës, biodiversitetit, peizazhit dhe monumenteve të natyrës. Peizazhi është territor tokësor ose ujor në të cilin natyra apo faktori njeri për kohë të gjatë kanë krijuar hapësira karakteristike me vlerë të theksuar ekologjike, estetike apo kulturore. Prandaj, ruajtja e integritetit të këtij bashkëveprimi duhet të bëhet gjithsesi sepse është esenciale për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit.

Në këtë hapësirë, pjesa më e madhe e sipërfaqeve është e mbuluar me pyje dhe kulloza, te cilat kanë ndikim pozitiv në aspektin e mbrojtjes së ajrit nga ndotja pasi që mundësojnë reduktimin e metanit dhe dyoksid karbonit, ndotës që lirohen pas pjekjes së gëlqerës. Prandaj funksionimi i tyre i ardhshëm duhet të kontrollohet me qëllim të respektimit të rregullave mjedisore në përgjithësi dhe mbrojtjes së ajrit në veçanti me sa më pak të ketë efekte të dëmshme në mjedis dhe në shëndetin e popullatës.

Uji është larg ndikimeve negative të faktorit njeri mirëpo masat që duhet ndermirren në mbrojtjen e ujë rrjedhave dhe burimeve natyrore janë me rëndësi për zonën. Mbeturinave e ngurta dhe ujërat e zeza shtrojnë nevojën që në këtë zonë të bëhet menaxhimi i mirë i mbetjeve të amvisërive si dhe të ndërtohen sisteme të kanalizimit të ujërave të zeza me qëllim të mbrojtjes së mirë të ujërave rrjedhës dhe tyre nëntokësor në këtë zonë.

Degradimi i pyjeve, shfrytëzimi joracional i shkëmbinjve gëlqeror si dhe hedhja e mbeturinave që në një masë janë prezentë në këtë zonë, për pasojë kanë degradimin e tokës. Shfrytëzimi joracional i pyjeve për djegie dhe për pjekje të shkëmbit gëlqeror, sjell deri të shpyllëzimi si dhe rritja e aktivitetit eroziv dhe prishja e peizazhit natyror. Për këtë arsye duhet të aplikohen masat për ruajtjen e florës në këtë zonë në harmoni me standardet aktuale.

Llojlojshmëria biologjike është ngushtë e lidhur me proceset evolutive të krijimit dhe ekzistencën, përkatësisht me shkaqet dhe rrethanat të cilat kanë sjell deri te paraqitja dhe zhvillimi i biodiversitetit. Prandaj është e domosdoshme që t'i kushtohet një kujdes shumë i madh mbrojtjes së natyrës e me këtë edhe mjedisit të njeriut sepse pasojat do të ndiejmë jo vetëm në por edhe gjeneratat e ardhshme. Rregullimi i raporteve të njeriut ndaj natyrës me qëllim të sigurimit afatgjatë të shfrytëzimit të resurseve natyrore, si dhe mbrojtja e drejtpërdrejt e disa pjesëve të natyrës të cilat për shkak të vlerave të veta shkencore, kulturore, ekonomike si dhe bukurive të rralla natyrore bazohet në ligjet ekologjike dhe krijohet përmes mbrojtjes adekuate.

Rëndësia shkencore e monumenteve të natyrës për shkencat natyrore është shumë e madhe meqenëse ato sigurojnë të dhëna të rëndësishme me të cilat shpjegohen dukuritë dhe ligjshmëritë të cilat sundojnë në natyrë. Monumentet natyrore janë si një lloj informacioni shumë i vlefshëm jo vetëm për studime shkencore të lëmenjve të ndryshëm, por edhe në aspektin kulturor, didaktik, turistik etj.

Duke pasur parasysh se veprimi negativ i njeriut ndaj natyrës dhe resurseve të saj ka qenë dhe po bëhet gjithnjë e më intensiv, është paraqitur nevoja që sa më urgjentisht të ndërmerren masat adekuate për mbrojtjen e natyrës me ç'rast mbrohet jo vetëm bota bimore dhe shtazore, por edhe vet njeriu.

Në këtë zonë është prezent monumenti natyror me karakter gjeomorfologjik i ashtuquajturit Guri i Gradinës që i takon kategorisë së III sipas IUCN-së i cili i jep zonës pamje atraktive dhe kërkon përkujdesje të vazhdueshme në të ardhmen.

4.2. Menaxhimi

Është e nevojshme të caktohet forma e organizimit dhe mënyra e shfrytëzimit të zonës me qëllim të administrimit dhe menaxhimit efikas të saj. Komunitet në të cilat shtrihet zona duhet të kenë një bashkëpunim të pandërprerë dhe të frytshëm për arritjen e këtij synimi. Rregullat dhe përgjegjësitë e secilës komunë duhet të jenë të definuar paraprakisht. Përfaqësimi dhe përgjegjësia e komunave do të varet nga territori që mbulojnë sipas kufirit të përcaktuar me planin hapësinor për ZIV "SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë". E gjithë kjo duhet të rregullohet me një memorandum bashkëpunimi, në të cilin në mënyrë të qartë do të përcaktohen obligimet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve pjesëmarrëse. Përpos komunave pjesëmarrëse, palë me rëndësi në këtë marrëveshje duhet të jenë edhe përfaqësuesit e sektorëve relevant të Qeverisë së Kosovës, që do të luajnë rolin e monitoruesit të zhvillimeve në zonë.

Pjesë me rëndësi e menaxhimit duhet të jetë informimi për vlerat historike, kulturore dhe natyrore të kësaj zone dhe promovimi i tyre brenda dhe jashtë vendit. Ky duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me ç'rast duhet të shfrytëzohen mënyra të ndryshme të informimit në të cilat duhet të përfshihen banorët e zonës, qytetarët e Kosovës, vizitorët e zonës dhe qytetarët e huaj, të cilët do të informohen përmes promovimit të zonës jashtë Kosovës. Promovimi i vlerave të zonës, përveç tjerash, duhet të ndikojë në tërheqjen e turistëve që si rrjedhojë do ta ketë zhvillim më të madh të turizmit dhe krijimin e një burimi të qëndrueshëm financiar.

4.3. Zhvillimi Social

Duke pasur në mendje kushtet jo të mira në të cilat zhvillohet procesi mësimor dhe shëndetësor, kërkohet që sa më parë të fillohet me përmirësimin e gjendjes fizike të objekteve e për të vazhduar me organizimin e trajnimit të mësimdhënësve, organizimin e kuizeve të ndryshme të diturisë për nxënësit, ofrimin e kurseve duke përfshirë kurset e gjuhëve të huaja dhe kurse të ndryshme teknike etj.

Në funksion të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të vlerave kulturo-historike të zonës është edhe edukimi i brezave të ardhshëm në frymën e atdhedashurisë përmes mësimin të historisë së zonës. Edukimi i brezave të ardhshëm për vlerat kombëtare dhe historike është njëri ndër objektivat më specifik në kuadër të planit hapësinor të zonës. Zona e Kleçkës dhe Divjakës ka merita dhe shquhet për veprimtarinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në organizimin e forcave mbrojtëse ushtarake të Kosovës. E tërë zona si e tillë ishte në mbështetje të aktiviteteve të Shtabit të Përgjithshëm me aktivitete të ndryshme logjistike dhe të tjera. Brezat e ardhshëm duhet së pari të informohen me korrektësi për veprimtarinë, e cila e shquan këtë zonë dhe në vazhdimësi për gjeneratat e ardhshme në mënyra të ndryshme përmes pjesëve arsimore, edukative etj.

Po ashtu, ofrimi i shërbimeve mjekësore gjatë tërë ditës si dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore gjithashtu paraqesin kërkesat që duhet të realizohen me qëllim të përmirësimit urgjent të kushteve mësimore dhe shëndetësore.

4.4. Zhvillimi Ekonomik

Zonat për rreth parkut duhet të jenë në funksion të parkut. Ky parim është në pajtim me mendimin e federatës ndërkombëtare për ruajtjen e natyrës (në kuadër të UNESCO), sipas së cilës duhet të shfrytëzohen kapacitetet jashtë zonës së parkut gjithmonë kur kushtet mundësojnë.

Për mbrojtjen dhe zhvillimin e parkut rol të veçantë ka popullata vendore e vendbanimeve brenda dhe në afërsi të parkut, e cila duhet të pranojë parkun si të vetin. Popullata duhet të informohet për përfitime ekonomike dhe vetëdijësohet për mundësinë e ngritjes së mirëqenies së tyre. Qeveria qendrore dhe ajo lokale duhet të mbështesë financiarisht resurset natyrore, të ndërtuara dhe ato njerëzore në zonë dhe rreth saj, konkretisht amvisëritë, ngritjen

e kapaciteteve të reja për blegtori, bletari, kapaciteteve për banim dhe ofrim shërbimesh tjera për turizëm fshatar, prodhimtari ekologjike, nga e cila do të përfitoj zona si dhe i gjithë vendi.

Çdo fshat i regionit është origjinal, si për mënyrën e gatimit ashtu edhe për pasuritë kulturore e folkloristike. Këto fakte nxjerrin në pah potencialin e turizmit rural dhe kulturor, i cili nuk duhet nënvlerësuar sepse zbutë ndjeshëm krizën në bujqësi dhe në papunësinë e banorëve. Peizazhi natyror përveç vlerave relaksuese, qetësisë shpirtërore që të dhuron, ka edhe fuqi edukuese, siç thoshte shkrymtari dhe filozofi i madh francez, lider i iluminizmit, Volteri, "Natyra ka pasur gjithmonë më shumë fuqi se edukimi". Zona ofron kushtet gjeografike-mjedisore, ekosistemet dhe peizazhet origjinale që përbëjnë potencialin kryesor turistik dhe që mundësojnë turizmin fshatar në këtë zonë. Me objektivin e zhvillimit të turizmit fshatar-ekologjik do të arrijmë ruajtjen dhe kultivimi i vlerave tradicionale dhe kulturore të popullatës përbrenda dhe rreth parkut, të cilat do të shtojnë atraktivitetin e vet parkut duke tërhequr kështu vizitorët.

Përveç zhvillimit të turizmit fshatar-ekologjik, si shtylla tjera të zhvillimit rural (zhvillimi rural - njëri prej synimeve për zonën) janë edhe zhvillimi i blegtorisë dhe ai i bletarisë. Në kuadër të planit për amvisëritë apo ekonomitë familjare vendore në këtë zonë planifikohet mbështetja për zhvillimin e blegtorisë, me alokim më të madh të fondeve nga buxheti i shtetit për sektorin e bujqësisë, meqë bujqësia është një nga segmentet më të rëndësishme të zhvillimit të ekonomisë së vendit. Nga shumë studime është mbështetur fakti i një lidhjeje pozitive ndërmjet investimeve të konsiderueshme në bujqësi dhe uljes së varfërisë në zonat rurale gjë që kontribuon direkt në rritjen e mirëqenies ekonomike të vendit. Është e rëndësishme të ndërgjegjësohet opinioni i përgjithshëm, në lidhje me kërkesat dhe nevojat esenciale të popullsisë në zonat rurale, të pjesëmarrjes së komunitetit në përgatitjen e planifikimit për të ardhmen, bazuar në praktikata të suksesshme nga vendet fqinje.

4.5. Infrastruktura

Zhvillimi i infrastrukturës fizike në zonë është bazë për zhvillimin rural. Prandaj, në mënyrë që të arrihet synimi për zhvillimin e kësaj zone rurale duhet të investohet në zhvillimin e infrastrukturës fizike.


Rrugët e asfaltuara nuk hyjnë në të gjitha lagjet e këtyre vendbanimeve, prandaj duhet të asfaltohen rrugët përmes të cilave arrihet në lagjet më të mëdha. Rruga që kalon nëpër pjesën e ZIV të komunës së Drenasit duhet të asfaltohet. Zhvillimi i infrastrukturës rrugore duhet të përcillet me zhvillimin e transportit publik që do të thotë se banorëve të të gjitha vendbanimeve të ZIV duhet t'u mundësohet qasja në transport publik.

Në mënyrë që të arrihet objektivi për një furnizim të rregullt me energji elektrike, duhet të investohet në përmirësimin e infrastrukturës së energjisë elektrike duke instaluar largpërçues dhe trafo të rinj.

Në ZIV nuk ka të instaluara sisteme të ujësjellësit dhe kanalizimit të ujërave të zeza, prandaj duhet të investohet që këto të instalohen në të gjitha vendbanimet e zonës.

Menaxhimi i mbeturinave është njëri prej objektivave për ZIV. Për arritjen e këtij objektiv është e nevojshme të ngritet infrastruktura për menaxhimin e mbeturinave dhe të sigurohet shërbimi i largimit të mbeturinave.

Të gjitha masat, projektet dhe aktivitetet e nevojshme në mënyrë të detajuar janë të paraqitura në tabelë. Për secilin synim të identifikuar janë paraqitur aktivitetet adekuate, me afatin e nevojshëm kohor dhe varësisht nga informatat është paraqitur edhe kosto e nevojshme për realizim, si dhe përgjegjësit kryesor që duhet të përkujdesën deri në realizimin përfundimtar të aktivitetit përkatës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostorong Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Instituti për Planifikim Hapësinor
Institut za Prosrorno Planiranje
Institute for Spatial Planning

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSORË E ZIV "KLEÇKË DHE DIVJAKË"

Legjenda

- | | |
|--------------------------------------|-------------------------------|
| 1 Radio Kosova e Lirë | 5 Shtabi i Brigadës 121 |
| 2 Selia e Qeverisë së Përkohshme | 6 Fshati i UÇK-së |
| 3 Shtabi i përgjithshëm i UÇK-së | 7 Batalioni i III Sadik Shala |
| 4 Lapidari i varrezave të dëshmorëve | |

Harta 10. Strategjia e zhvillimit hapësinor për ZIV “SHP-Kleçkë dhe Divjakë”

Plani i aktiviteteve sipas strategjisë dhe synimeve të përcaktuara

S1. Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i vlerave historike-kulturore të parkut

Synimi	Objektivi	Numri i aktiviteteve	Veprimi: projekt/masë/ aktivitet	Afati	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Zbatues	Investitori			
							Buxheti në mija Euro	BKK	Donac	PPP
							Total			
S1 .Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i vlerave historike-kulturore të parkut .	S1.O1. Promovimi i parkut historik dhe kulturor Kleçkë dhe Divjakë, brenda dhe jashtë Kosovës;	P1	Hartimi i strategjisë për promovimin e parkut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtarë;	*	MTI/DT	DT	120,000	%	%	
		P2	Nevojat për operoret dhe profesionistët turistik;	*	MTI/DT	MTI/DT	5,000	%		%
		P3	Zyrat e informimit – turistik brenda zonës;	Vazhdueshëm	MTI/ Komunitat Pjesmarr.	MTI	3,000			%
		P4	Hartimi i Broshurave informative për "Parkun historik - kulturor Kleçkë dhe Divjakë"	*	MTI/DT	MTI/DT	10,000	%		
		A	Distribuimi i materialit propagandues;	Vazhdueshëm	MTI/DT /MPJ, Ambasadat	MTI/DT	30,000	20,000	10,000	
	S1.O2. Edukimi, informimi dhe promovimi i vlerave historike, kulturore, natyrore dhe turistike për ZIV "Kleçkë dhe Divjakë";	P1	Organizimi i "Ditëve të poezisë në Kleçkë dhe Divjakë" në lokacionin e memorialit; (në të cilën do të ndahen çmime për krijime letrare);	Qdo vit në përvjetore	MASHT, MKRS, OJQ.SH. L UÇK-ës	Drejtoria Parkut K-D	10,000	%	%	%
		P2	Promovimi i Parkut Historik Kleçkë dhe Divjakë, në suaza gjithëkombëtare dhe më gjerë, atë ndërkombëtare	Vazhdueshëm	MASHT, MKRS, MTI/DT / MPJ, Ambasadat OJQ, SHL-të		10,000	%		
		P3	Organizimi i Qendrës Edukative në kuadër të Zonës në të cilin objekt do të mund të shoqërohen dhe organizohen aktivitete të ndryshme kulturore dhe edukative për veprimtarinë historike në KD.	Vazhdueshëm	MTI / DT/ MSHT ASHAK	MSHT				

	P4	Unifikimi i historisë mbarë kombëtare në plan programe arsimore për luftën e UÇK-së; (në të gjitha viset ku jetojnë shqiptarët).	***	MASHT-Kosovë & MASHT Shqipëri	MASHT	60,000	*		
	P5	Organizimi i ekskursioneve tradicionale për fëmijët e shkollave fillore dhe ato të mesme,	Vazhdueshëm	MASHT	MASHT				
S1.O3. Bashkëpunimi i komunave në të cilat gjendet zona;	M1	Definimi dhe hartimi I rregullave dhe përgjegjësi të komunave pjesëmarrëse ne zonë	*	MMPH		1,500	%		
	M2	Nënshkrimi I Marrëveshjes për komunat pjesëmarrëse(Drenas, Lipjan, Malishevë)	*	MMPH dhe Komunitat Lipjan, Malishevë, Drenas dhe Suharek	MMPH	2,000	%		
S1.O4. Menaxhimi objekteve historiko-kulturore dhe natyrore të zonës;	P1	Krijimi i bazës së të dhënave për objektet me vlera historike;	*	MMPH	MMPH	2,000	%		
	P2	Hartimi i PRrU për zonat e identifikuar në PH ZV “KD	*	MMPH	MMPH	120,000	%		
	P3	Hartimi i projektit për restaurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe monumenteve përkujtimore të cilat ruajnë kujtimin për luftën e UÇK-së,	**	MMPH / MKRS	MMPH / MKRS	160,000	%		
	P4	Hartimi i planit për menaxhimin e Parkut Historiko- Kulturor;	***	MMPH	MMPH	200,000	%		
	P5	Themelimi i drejtorisë së parkut në nivel të qeverisë e cila do të menaxhoj parkun;	*	MMPH	MMPH	5,000	%		
	P6	Ngritja e punkteve kontrolluese dhe informative në funksion të parkut;	*	MMPH	MMPH	60,000	%		

Tabela 3. Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i vlerave historike-kulturore të parkut

Synimi 2 - Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i vlerave natyrore të parkut

Synimi	Objektivi	Numri i aktiviteteve	Veprimi: projekt/mas/ aktivitet	Afati	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Zbatues	Buxheti në mija Euro	Investitori		
							Total	BKK	Donac	PPP
Synimi 2 - Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i vlerave natyrore të parkut	S2.O1. Mbrojtja e ajrit	M1	Monitorimi I furrave të gëlqeres	Vazhd.	MMPH	MMPH	1,000	%		
		P1	Mbyllja furrave të gëlqerore si dhe mundsit per zhvillime tjera ne Bujqësi	**	MMPH ,MBPZ HR	MMPH	45,000	5,000	20,000	20,000
		P1	Të vendoset sistemi per monitorimin e cilësisë se ajrit.	*	MMPH	MMPH IHMK	5,000	5,000		
	S2.O2. Mbrojtja e ujit	P1	Ndërtimi I gropave septike per ujërat e zeza dhe kanalizimeve si mas parandaluse deri sa te lidhen me impiant per trajtim	**	MMPH DU	MMPH	250,000	100,000	100,000	50,000
		M1	Parandalimi I hedhjes se mbeturinave te amvisris si dhe mbetjeve te bujqësisë ne prrrockat e lumenjve	Vazhd.	MMPH DMM	MMPH DMM	10,000	10,000		
		P1	Evidentimi I burimeve ujore dhe masat mbrojtëse	**	MMPH DU IHMK	MMPH DU IHMK	20,000	20,000		
	S2.O3 Mbrojtja e Tokës	P1	Ripyllëzimi dhe pyllëzimi I 100 ha me qellim parandalimi te erozionit	***	MMPH MBPZ HR AP	MMPH MBPZ HR AP	70,000	70,000		
		M1	Parandalimi I prerjeve ilegale të pyjeve	Vazhd.	Agjenci oni pyjoir	Agjenci oni pyjoir	-			
		M2	Kontroll strikt I vendburimeve te gurit gëlqeror	Vazhd.	MMPH DMM, Inspekt oriati	MMPH DMM Inspekt oriati	-			
		P2	Pastrimi I mbetjeve ne ter parkun	*	MMPH Komun at	MMPH Komun at	35,000	35,000		
	S2.O4. Mbrojtja e peizazhit, biodiversitetit dhe Monumenteve Natyrore brenda zonës	M1	Mbrojtja dhe ruajtja e monumentit të natyrës „Guri Gradinës"	*	MMPH DMM AMMK	MMPH DMM AMMK	-			
		P2	Shpallja si monument I natyrës„Maja Pallanik"	*	MMPH	MMPH DMM AMMK	3,500	3,500		

	M1	Parandalimi i gjuetisë në park	Vazhd.	MMPH APK	MMPH APK	-			
	P2	Hulumtimi I bimëve endemike në zonë	**	MMPH DMM	MMPH DMM	12,000	12,000		

Tabela 4. Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i vlerave natyrore të parkut

Synimi 3 - Zhvillimi rural

Synimi	Objektivi	Numri I aktiviteteve	Veprimi: projekt/masë/ aktivitet	Afati	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Zbatues	Buxheti në milion Euro			
							Total	BKK	Donac.	PPP
S3.O1. Zhvillimi i turizmit fshatar-ekologjik	M1	Krijimi i lehtësirave për investimet në turizëm	**	MTI DT	MTI	3,000	%			
	P2	Bashkëpunimi i DT-it me asociacionet turistike	**	MTI DT	MTI DT	5,000	%			
	P3	Hartimi i PRr për mjediset që ka rëndësi për zhvillimin e turizmit fshatar;				-				
	P4	Mbështetje dhe angazhimi i OJQ-ve për vetëdijësim të popullatës, për ruajtjen e vlerave tradicionale folklorike, gatimit tradicional të popullatës që jetojnë në dhe pranë parkut në dobi të turizmit;	***	MMPH /MKRS / MTI		-				
	A	Organizimi i vizitave në vendet me përvojë në turizmin rural ; (praktikat të mira)	Vazh duesh ëm	OJQ	OJQ	7,500	%	%		
	A	Nxjtja e zhvillimit të infrastrukturës turistike të nivelit lokal;(adaptimi dhe renovimi i shtëpive për bujtina.)	**	MTI OJQ	MTI OJQ	10,000	3,000	1,000	6,000	
	A	Trajnim Turistike per Hoteleri per vendasit për organizimin dhe mirëmbajtjen e bujtinave	**	OJQ	MMPH / MTI	5,000			5,000	

S3.O2. Zhvillimi i blegtorisë dhe bletarisë	A	Organizimi për grumbullimin e frutave të imta dhe bimëve mjekuese;	vazhdueshëm	MBPZH R	OJQ	3,000			3,000	
	P5	Hartimi i broshurave për informim, marketing të promocionit turistik.	*	MTI MMPH / OJQ	MMPH	4,500	%			
	P6	Mbështetje në hapjen e punëtorive me veprimtari artizanale;	***	OJQ	OJQ	5,000			5,000	
	P1	Mbështetje për zhvillimin e blegtorisë dhe bletarisë në ZIV Kleçkë dhe Divjakë,	**	MBPZH R	MBPZ HR	50,000	20,000	20,000	10,000	
	A	Subvencionimi dhe ringjallja e blegtorisë				-				
	A	Mundësimi i kredive të favorshme, me kamata të ulëta dhe kthim afatgjatë	vazhdueshëm	MBPZH R	MBPZ HR	-				
	P2	Organizimi i punëtorive dhe shërbimeve këshillëdhënëse për rritjen e cilësisë së kultivimit blegtoral dhe bletarisë;	**	MBPZH R OJQ	MBPZ HR	5,000	5,000			
	P3	Rritja e fondit të gjedheve dhe përmirësimi i racës;	***	MBPZH R	MBPZ HR	40,000	20,000	10,000	10,000	
	S3.O3. Ngritja e cilësisë në arsimim dhe shëndetësi		Ndërtimi I shkollës së re në Novosell	**	MASHT	MASH T	220,000	%		
			Ndërtimi I ambulancës së re në Novosell	**	MSH	MSH	80,000	%		
			Rregullimi I kulmit në shkollën fillore në Kleçkë	*	MASHT	MASH T	20,000	%		
			Furnizimi me ujë I Sh.f Kleçkë	*	MASHT	MASH T	1,500	%		
S3.O4. Sigurimi i qasjes për rrugë në të gjitha objektet dhe monumentet e zonës dhe sigurimi i transportit publik		Ndërtimi i rrugëve të asfaltuara që lidhin rrugën ekzistuese të asfaltuar me brendinë e fshatrave	**	Komunat respektive	Komunat respektive; Firmat ndërtimore	1,200,000		1,200,000		

	Ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë që lidhin të gjitha hapësirat me përbajtje të caktuara brenda ZIV (Planet rregulluese urbane i caktojnë trasetë e këtyre shtigjeve.)	**	Komunat respektive	Komunat respektive; Firmat më të mëdha	320,000	320,000		
	Ndërtimi i parkingjeve afër hapësirave me përbajtje të caktuara (Planet rregulluese urbane tregojnë më detalisht ku do të ndërtohen parkingjet)	**	Komunat respektive	Komunat respektive; Firmat më të mëdha				
	Vendosja e linjës së rregullt të transportit publik deri tek të gjitha hapësirat me përbajtje të caktuara brenda ZIV	*	MI	MI; Operatori i transportit publik				
S3.O5. Sigurimi i furnizimit me energji elektrike	Ndërtimi i linjave furnizuese 10 kV gjegjësisht 0.4 kV me trafostacione përcjellës në ato hapësira që nuk përfshihen nga këto linja	***	MZHE; ZRRE	MZHE; Ndërmarrja e energjisë elektrike				
	Zëvendësimi i linjave ajrore me ato kablore nëntokësore	***	MZHE; ZRRE	MZHE; Ndërmarrja e energjisë elektrike				
	Vendosja e shtyllave për ndriçim publik të fshatrave, rrugëve dhe të gjitha hapësirave me përbajtje të caktuara brenda ZIV	**	Komunat respektive	Komunat; Ndërmarrja e energjisë elektrike	300,000	300,000		
S3O6. Ndërtimi i infrastrukturës ujore	Ndërtimi i ujësjellësve në të gjitha fshatrat dhe hapësirat tjera me përbajtje të caktuara	**	MMPH; Autoriteti i Rajonit të Pellgut Lumor; Komunat respektive	Komunat respektive; Operatori i shërbimit publik		Buxheti komunal		
	Ndërtimi i kanalizimeve të ujrave të zeza në të gjitha fshatrat dhe hapësirat tjera me përbajtje të caktuara	**	MMPH; Autoriteti i Rajonit të Pellgut Lumor; Komunat respektive	Komunat respektive; Operatori i shërbimit publik		Buxheti komunal		

S3O7. Menaxhimi mbeturinave	Vendosja e shportave dhe e kontejnerëve të mbeturinave në vende të caktuara në fshatra dhe në hapësirat tjera me përmbajtje të caktuara	Komunat respektive	Komunat respektive; Operatori për administrimin e mbeturinave	Buxheti komunal
	Vendosja e shërbimit të largimit të mbeturinave	Komunat respektive	Komunat respektive; Ndërmarrja për grumbullimin e mbeturinave	Buxheti komunal

Tabela 5. Zhvillimi rural

- * Afat shkurt 0-3 vite realizimi i projekteve
- ** Afat mesëm 3-5 vite realizimi i projekteve
- *** Afat gjatë 5-10 vite realizimi i projekteve
- Vazhdueshëm - projektet vazhdoen pa ndërpre

Kostoja e të gjitha projekteve është rreth 3,500,000 €, ndersa sipas paralogarive dhe paramasave, realizimi dhe implementimi i projekteve të Planit rregullues është rreth 14.500.000 € investime të mundshme.

V DISPOZITAT PËR ZBATIM

Dispozitat për zbatim përmbajnë kushtet dhe masat me karakter obligativ që respektivisht duhet të plotësohen dhe të ndërmerren gjatë zbatimit të planit hapësinor. Ato janë të përkufizuara me elemente esenciale për territorin e Zonës me Interes të Veçantë „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë”. Këto dispozita drejtojnë zbatimin e planit.

Dispozitat e përgjithshme

- Plani Hapësinor i për Zonën me Interes të Veçantë „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” është dokumenti kryesor për rregullimin dhe zhvillimin hapësinor të zonës;
- Dokumenti i PH ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” mbulon periudhën prej së paku dhjetë vitesh, duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi.
- Të gjitha komunat të cilave përfshihen në këtë zonë, janë të obliguara që planet e veta përkatëse ti harmonizojnë me rekomandimet dhe dispozitat që parashihen me këtë Plan;
- Plani Hapësinorë për Zonën me interes të veçantë „SHP.UÇK.Kleçkë-Divjakë” Përcakton saktë kufijtë e zonave që duhet të kalojnë procesin për shpronësim të përcaktuara me Planin Rregullues urban për Zonën .

Shpronësimi kryhet konform Ligjit për shpronësimin e pronës së pa lujtëhme . Me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të dates 28 tetor 2010.

Zonat për shpronësim janë përcaktuar me Plan Hapësinorë:

Zona 1 - Shtëpia muze e "Radio Kosova e lirë" 0.23Ha dhe Agjencia e lajmeve "Kosova Press" 0.20Ha

Zona 2 - Selia e Përkohshme e Qeverisë së Kosovës 0.68Ha

Zona 3 - Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe spitali ushtarak 81.84Ha

Zona 4 - Lapidari dhe varrezat e dëshmorëve 1.54Ha

Zona 5 - Shtabi i Brigadës 121; 1.85Ha

Zona 6 - Fshati i UÇK-së; 5.0Ha

Zona 7 - Selia e shtabit të Komandant Kumanovës. 0.44Ha

- Rishikimi dhe Revidimi eventual i dokumentit duhet të bëhet në periudhën prej pesë vitesh. Në raste të veçanta revidimi mund të bëhet edhe sipas nevojës.
- Përgjegjës për rishikim dhe revidim është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përkatësisht Instituti për Planifikim Hapësinor;
- Ky dokument hyn në fuqi pasi të jetë miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës;

5.1. Kushtet dhe masat të përcaktuara nga Qeveria, si dhe nga pushteti lokal mbi çështje të rëndësishme për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës në zonën e veçantë për të cilën hartohet plani.

5.1.1. Kushtet për përcaktimin dhe përkufizimin e sipërfaqeve publike, si dhe atyre me destinime të tjera.

- Caktimi i sipërfaqeve publike dhe i atyre me destinime tjera duhet t'i plotësojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit, ngritjes së kualitetit të jetesës dhe mosrrezikimit të shëndetit të popullatës, shfrytëzimit racional të territorit dhe të resurseve natyrore.
- Kryesisht pronësia e tokës e përcakton vendin e sipërfaqeve publike. Pra sipërfaqet publike parimisht janë në tokat që janë në pronësi publike, mirëpo nëse Qeveria vlerëson se është në interes kombëtar që disa toka në pronësi private t'i kthejë në sipërfaqe publike, ajo do ta bëjë këtë.
- Sipërfaqe publike do të jenë ato hapësira ku ndodhen shumica e ndërtesave që gjatë luftës janë përdorur nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), ku ndodhen dhe ku do të ndërtohen objekte shkollore, infrastruktura rrugore (rrugët automobilistike, shtigjet e këmbësorëve dhe parkingjet), objekte dhe terrene të hapura për sport e rekreacion dhe hapësirat që janë sipërfaqe të lira, të gjelbëruara.
- Kur caktohen vendet e sipërfaqeve publike dhe të atyre me destinime tjera ku do të ketë ndërtime, përparësi kanë vendet ku ekziston infrastruktura e domosdoshme teknike si qasja e lehtë përmes rrugës, energjia elektrike, ujësjellësi dhe kanalizimi. Nëse nuk ekziston infrastruktura, është e domosdoshme që para se një zonë të destinohet për ndërtim, të ndërtohet infrastruktura.
- Ndërtimi në sipërfaqet publike dhe në ato me destinime tjera duhet të bëhet sipas parametrave urbanistik, arkitektonik dhe teknik që caktohen me planet rregulluese urbane dhe projektet arkitektonike të ndërtesave.
- Objektet e arsimit fillor duhet të vendosen brenda hapësirave të destinuara për banim ose fare pranë tyre. Hapësirat ku janë të vendosura këto objekte duhet të rregullohen me breza mbrojtës dhe të jenë të arritshme nga transporti publik. Në kuadër të oborrit shkollor duhet të sigurohet hapësirë e gjelbërt dhe terrene të hapura sportive.
- Si sipërfaqe të lira të gjelbëruara duhet të mbeten sipërfaqet e pyllëzuara, por edhe sipërfaqe të tjera nëse këtë e lejon plani hapësinor i ZIV dhe planet rregullues urban të ZIV.
- Sipërfaqet publike dhe ato me destinime tjera rregullohen hollësisht me planet rregulluese urbane.
- Sipërfaqet që destinohen për veprimtari tregëtare – furnizim të popullatës me mallra të konsumit të përditshëm duhet të jenë brenda hapësirave të destinuara për banim ose fare pranë tyre dhe pranë zonave ku ndodhen ndërtesat historike të shfrytëzuara nga UÇK gjatë luftës.

5.1.2. Kushtet për rregullimin e hapësirës për objektet me rëndësi për Kosovën dhe komunën

- Objekte me rëndësi për Kosovën dhe komunën në ZIV „SHP.UÇK. Kleçkë dhe Divjakë“ janë ndërtesat historike të shfrytëzuara nga UÇK gjatë luftës.
- Në hapësirën ku ndodhen këto objekte duhet të ketë qasje të mirë përmes rrugës automobilistike dhe asaj për këmbësorë dhe të sigurohet e tërë infrastruktura tjetër e nevojshme.
- Hapësira ku ndodhen këto objekte rregullohet më hollësisht me plane rregulluese urbane.

- Në këtë hapësirë nuk lejohet asnjë intervenim që nuk është në përputhje me këtë plan hapësinor dhe me planet rregullues urban.

5.1.3. Kushtet për rregullimin e zonave dhe tërësive me vlerë të veçantë

- Në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” ka hapësira me vlera natyrore dhe hapësira apo tërësi me vlerë historike.
- Në hapësirën apo zonën me vlera natyrore duhet të ketë qasje të mirë përmes shtigjeve për këmbësorë, kurse në hapësirën me vlerë historike ku ndodhen ndërtesat e shfrytëzuara nga UÇK gjatë luftës, duhet të sigurohet e tërë infrastruktura e nevojshme fizike dhe shërbimet që lidhen me të.
- Zonat dhe tërësitë me vlerë të veçantë duhet të mbrohen nga degradimi i mjedisit dhe dëmtimi fizik i objekteve që ndodhen atje.
- Hapësirat me vlera natyrore dhe historike rregullohen me planin hapësinor për ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” dhe më hollësisht me planet rregulluese urbane.
- Në këto zona dhe tërësi nuk lejohet asnjë intervenim që nuk është në përputhje me këtë plan hapësinor dhe me planet rregullues urban.

5.1.4. Kushtet për vendosjen e objekteve gjegjëse në zonën e veçantë për të cilën nxirret Plani

- Në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” nuk mund të vendoset asnjë objekt në kundërshtim me planin hapësinor për këtë zonë.
- Në sipërfaqet për të cilat janë përpiluar planet rregullues urban, objektet mund të vendosen vetëm sipas këtyre planeve.
- Në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” nuk mund të vendoset asnjë objekt që do të kishte si pasojë, në një apo në një formë tjetër, ndotjen apo degradimin e mjedisit.
- Asnjë objekt nuk mund të vendoset në sipërfaqen e brezave mbrojtës të rrugëve automobilistike.
- Asnjë objekt nuk mund të vendoset në tokën bujqësore, përveq në rastin kur këtë e lejon plani rregullues urban.
- Asnjë objekt nuk mund të vendoset në tokën me pronësi shoqërore, përveq kur është sipas planit rregullues urban.

5.1.5. Kushtet për përcaktimin e rrjetit të sipërfaqeve të korridoreve apo traseve telekomunikuese dhe rrjetit të infrastrukturës komunale

- Shtigjet për këmbësorë duhet të ndërtohen me gurë apo me materiale tjera që i përshtaten dhe janë në harmoni me rrethinën në të cilën ndërtohen;
- Në vendet e duhura, si aty ku fillon territori i ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” dhe përgjatë shtigjeve për këmbësorë, duhet të vendosen tabelat me informatat e nevojshme për vizitorët;
- Ndalohet çfardo ndërtimi në sipërfaqet në të cilat ky plan hapësinor e parasheh ndërtimin e rrugëve të reja automobilistike dhe në sipërfaqet e brezave mbrojtës të këtyre rrugëve;
- Ndalohet çfardo ndërtimi në sipërfaqet e brezave mbrojtës të rrugëve ekzistuese automobilistike;
- Brezi mbrojtës rrugor paraqet sipërfaqen në të dy anët e autoudhëve, rrugëve nacionale, regionale dhe lokale. Gjërësia e këtij brezi në rrugët nacionale, regionale dhe lokale është përcaktuar me Ligjin Nr. 2003/11 – Ligjin për Rrugët;

- Qeveritë komunale janë kompetente për rrugët lokale në territoret e komunave të tyre, prandaj ndërtimi i këtyre rrugëve realizohet me lejen dhe nën mbikqyrjen e organeve kompetente komunale;
- Gjatë ndërtimit të rrugëve automobilistike, duhet të respektohen rregullat mbi kriteret teknike (gjërësia, pjerrtësia, shtresat dhe trashësia e tyre) për ndërtimin e tyre, rregulla të cilat i ka nxjerrë Ministria e Infrastrukturës (MI);
- Përgjatë rrugëve automobilistike të zonës duhet të vendosen të gjitha shenjat e nevojshme të komunikacionit;
- Për çdo qasje me rrugë nga lokacionet ku do të ketë ndërtime me dedikim të caktuar në rrugët nacionale dhe regjionale, duhet të merret leja nga MI;
- Peshat dhe dimensionet e automjeteve që qarkullojnë nëpër rrugët automobilistike të zonës duhet të jenë në pajtueshmëri me rregullat e veçanta lidhur me këtë që i ka nxjerrë MI;
- Transportin publik të udhëtarëve mund ta realizojnë vetëm operatorët e licencuar të transportit. Licencimi bëhet nga MI;
- Në mënyrë që transporti i udhëtarëve të jetë sa më i sigurtë, automjetet transportues që i posedon operatori i transportit, duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet teknike që i ka përcaktuar MI;
- Gjatë ndërtimit të parkingjeve duhet të respektohen rregullat mbi kriteret teknike për ndërtimin e tyre, rregulla të cilat i ka nxjerrë MI;
- Numrin e parkingjeve, vendin e tyre të saktë në hapësirë dhe standardet për parkingje i përcakton plani rregullativ për zonën e caktuar.
- Asnjë ndërmarrje ndërtimore nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e vet pa qenë e licencuar nga Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë;
- Ndërmarrjet e energjisë që do t'i kryejnë punët e distribuimit dhe të furnizimit të qytetarëve me energji elektrike duhet të jenë të pajisura me licencë nga ZRRE;
- Punët në ndërtimin apo zgjerimin e rrjetit të distribuimit të energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror duhet të kryhen në përputhshmëri të plotë me kodet teknik që i përpilojnë ndërmarrjet e energjisë dhe të cilët i miraton ZRRE.
- Për ndërtimin e sistemeve publik të ujësjellësve dhe kanalizimeve të ujrave të zeza, duhet të merret leja nga Autoriteti Rajonal i Pellgut Lumor;
- Të drejtën për administrimin me mbeturinat në zonë e kanë vetëm operatorët për administrimin e mbeturinave që janë të pajisur me licencë nga MMPH;

5.1.6. Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike

- MMPH në bashkëpunim me komunat ku shtrihet ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” merr masa për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike të kësaj zone duke siguruar që të zbatohen: plani hapësinor për këtë zonë, planet zhvillimore komunale dhe planet rregulluese urbane për këtë zonë.
- Nuk lëshohen leje ndërtimore nëse ndërtimet do të jenë të pabazuara në planin hapësinor të zonës dhe planet rregulluese urbane për këtë zonë.
- MMPH dhe komunat përkatëse janë përgjegjëse për monitorim të vazhdueshëm të zhvillimeve hapësinore në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” dhe për shkeljet eventuale marrin masa në përputhje me rregullat në fuqi.
- Masat për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja janë:
 1. Moslejimi i ndërtimit të çfarëdo objekti industrial që do të ndotë ajrin, përrockat ujore apo tokën;

2. Mbrojtja e krojeve;
 3. Vënja nën kontrollë e furrave të gëlqeres me ç'rast duhet të ndalohej djegja e gomave për shkrirjen e gëlqeres;
 4. Ndalimi i hedhjes së mbeturinave në përrockat ujore dhe në tokë dhe vendosja e kontejnerëve ku do të hedheshin mbeturinat
- Nuk lejohen ndërtimet, eksploatimi i pasurive dhe çdo veprimtari tjetër që do të dëmtonte zonën e mbrojtur ku ndodhet monumenti natyror Guri i Gradinës.
 - MBPZHR në bashkëpunim me komunat ku shtrihet ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” merr masa për mbrojtjen e pyjeve dhe tokës bujqësore të kësaj zone.
 - Agjencia e Pyjeve të Kosovës që është pjesë e MBPZHR së bashku me njësitë e saj nëpër komuna drejton shërbimin e mbrojtjes së pyjeve që përbëhet nga rojet e pyjeve. Këta rojtarë duhet ti ushtrojnë autorizimet dhe kompetencat që i kanë për mbrojtjen e pyjeve sipas Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës.
 - Prerja e drunjve dhe format tjera të shfrytëzimit të pyjeve, si të atyre në pronësi private poashtu edhe të atyre në pronësi shoqërore, mund të bëhen vetëm ashtu siq e thot Ligji Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës dhe Ligji Nr. 2004/29 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës.
 - Inspektori i bujqësisë duhet t'i ushtrojë autorizimet që i ka për mbrojtjen e tokës bujqësore sipas Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore.
 - Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të bëhet vetëm sipas Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore.
 - Tërësinë historike në zonë e formojnë ndërtesat që janë shfrytëzuar nga UÇK gjatë luftës e që tani konsiderohen si ndërtesa historike. Ato duhet të riparohen dhe riparimi nënkupton kthyerjen e tyre në gjendjen e mëparshme që do të thotë ruajtjen e plotë të origjinalitetit të tyre arkitektonik.
 - Sigurimin e ndërtesave historike e realizon personeli i caktuar nga autoritetet kompetente.

5.1.7. Mënyra e trajtimit të hedhurinave

- Mbeturinat nuk mund të hudhen kudo në hapësirën e ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë”. Ato duhet të jenë nën administrimin (grumbullimi, mbledhja, ndërmjetësimi, shitblerja, manipulimi, transportimi, përpunimi, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave) e personave (person fizik apo juridik) për administrimin e mbeturinave.
- Personat (zotëruesi i mbeturinave, prodhuesi i mbeturinave, transportuesi i mbeturinave, operatori për trajtimin e mbeturinave, operatori i deponisë) për administrimin e mbeturinave duhet t'i përmbushin detyrimet që janë të rregulluara me Ligjin Nr. 02/L-30 për Mbeturinat.
- Aktivitetet që duhet t'i kryejnë personat për administrimin e mbeturinave janë të rregulluara me Ligjin Nr. 02/L-30 për Mbeturinat.
- Personat për administrimin e mbeturinave duhet të jenë të pajisur me licenca të cilat i lëshon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).
- Ligji Nr. 02/L-30 për Mbeturinat obligon mbikqyrjen inspektuese të aktiviteteve për administrimin e mbeturinave. Këtë punë e kryen Inspektorati për mbrojtjen e mjedisit që është në kuadër të MMPH-së.
- Inspektori duhet t'i kryejë detyrat që i ka sipas Ligjit Nr. 02/L-30 për Mbeturinat.

5.1.8. Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis

- Në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” duhet të parandalohet ndikimi i dëmshëm në ajër, në krojet, përrockat ujore dhe në tokë, ndikim që do të mund të vinte nga ndonjë kapacitet ndotës industrial, djegja e gomave për shkrirjen e gëlqeres, hedhja e mbeturinave në rrjedhat ujore dhe në tokë, prerja ilegale e pyjeve apo cenimi i monumenteve natyrore përmes aktiviteteve të paplanifikuara dhe të jashtëligjshme.
- Pengimi i ndikimeve të dëmshme në mjedis bëhet duke futur në funksion instrumentet për mbrojtjen e mjedisit që janë të listuar në Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit e që janë:
 - Infrastruktura ligjore;
 - Dokumentet për mbrojtjen e mjedisit;
 - Instrumentet ekonomike;
 - Dokumentet për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
 - Instrumentet për monitorimin e mjedisit;
 - Menaxhimi i mbrojtjes së mjedisit nga personat juridik ose fizik.
- Infrastruktura ligjore – Përdorimi i këtij instrumenti nënkupton zbatimin e të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit si: Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ligji për Pyjet e Kosovës, Ligji për Mbeturinat dhe Ligji për Minierat dhe Minerat.
- Dokumentet për mbrojtjen e mjedisit janë: Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit, Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis, Planet e Veprimit Lokal në Mjedis dhe Programet Mjedisore. Këto plane duhet të zbatohen me përpikëri në mënyrë që të pengohet ndikimi i dëmshëm në mjedis.
- Dokumentet për vlerësimin e ndikimit në mjedis janë: Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM). VSM bëhet për planet dhe programet të cilat kanë mundësi të kenë ndikim të theksueshëm në mjedis, kurse VNM bëhet për projektet të cilët planifikohen të realizohen në hapësirë të caktuar e që mund të kenë ndikim të dëmshëm në mjedis. Është e domosdoshme të bëhet VNM për projekte të caktuara që i parasheh plani dhe planet rregullativ urban. Nuk mund të fillojë zbatimi i projekteve të caktuara pa u bërë VNM.

5.1.9. Masat për parandalimin e ndikimit negativ social

- Veprimtaria, aktivitetet apo projektet që parashihen me plan hapësinor dhe plane rregullues urban dhe që do të zhvillohen në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” nuk guxojnë të kenë ndikim negativ në gjendjen apo mirëqenjen sociale atje. Përkundrazi ato duhet të ndikojnë pozitivisht në rritjen e mirëqenjes sociale në zonë.
- Është e nevojshme të jetësohen të gjitha projektet që parashihen me këtë plan hapësinor dhe me planet rregullues urban e që kanë të bëjnë me zhvillimin social siq janë: ndërtimi i shkollës, i shtëpisë së shëndetit, i muzeut, i pushimoreve etj.
- Përparësi që të punësohen në vendet e reja të punës që do të hapen me zbatimin e planit hapësinor dhe planeve rregullues urban duhet të kenë banorët vendas.
- Në projektimin e objekteve që parashihen sipas planeve në ZIV „SHP. UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” duhet të aplikohen normat që ofrojnë infrastrukturën e nevojshme për qarkullimin e personave me nevoja të veçanta (rampat në objekte, parkingjet, vendkalimet, trotuare të projektuara në formën që lehtësojnë lëvizjen e lirshme të kësaj kategorie, hyrjet dhe qarkullimin e lehtë në lokale etj). Komunitat nuk do të lëshojnë asnjë leje ndërtimi për objektet për të cilat nuk është marrë parasysh aplikimi i këtyre normave.

5.1.10. Masat për zbatimin e planit

Masat për rregullimin dhe mbrojtjen e tokave

- Përpilimi i planeve rregulluese urbane
- Masat për mbrojtjen e tokave nga ndërtimet e paplanifikuara, të paligjshme që konsistojnë në:
 - Moslëshimin e lejeve ndërtimore nga komunat për ndërtimet që nuk janë të mbështetura në planin hapësinor dhe në planet rregulluese urbane;
 - Kryerjen me përpikëri të detyrave që sektorët e ndërtimit në kuadër të drejtorive të inspektoratit të komunave i kanë sipas statuteve dhe rregulloreve të komunave.
- Destinimi i tokës përcaktohet me planin hapësinor për ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” dhe me planet rregulluese urbane për këtë zonë. Nuk lejohet asnjë ndërrim i destinimit të tokës që është në shpërputhje me këto plane.

5.2. Dispozitat lidhur me konsultimin, bashkëpunim dhe pjesëmarrje

- Kompanitë që përpilojnë planet rregulluese urbane, gjatë procesit të përpilimit duhet të mbajnë kontakt të vazhdueshëm me MMPH me qëllim të konsultimit dhe njohtimit të MMPH për ecurinë e procesit.
- Kompanitë që përpilojnë planet rregulluese urbane duhet të jetësojnë parimin për promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes dhe përfshirjes duke siguruar kështu pjesëmarrjen dhe përfshirjen e publikut (qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit) qysh në fazat e fillimit dhe gjatë gjithë procesit të përpilimit të planeve dhe të ndërmarrin fushatë informimi ashtu siç është parapa me dispozitat e ligjit për planifikim hapësinor.
- Duhet të ekzistojë një bashkëpunim i frytshëm në trekëndshin Qeveri – komuna – kompania përpiluese e planit rregullues në mënyrë që të gjenden investitorët për projektet që parashihen me planet rregulluese urbane. Investimet mund të jenë qeveritare, krejtësisht private, por mund të krijohen edhe partneritete publike-private.

5.3. Dispozitat mbi rendin kronologjik apo etapat e zbatimit

- Me propozim të MMPH, Qeveria e Kosovës e miraton themelimin e një njësie (drejtori) për menaxhim me ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë”. Kjo njësi që do ta menaxhojë zonën, do ta përcjellë zbatimin e planit hapësinor dhe planeve rregulluese të zonës dhe do t’i monitorojë zhvillimet hapësinore në zonë. Hartimi i raporteve vjetore informuese do të jetë poashtu punë e kësaj njësie.
- Projektet apo aktivitetet do të realizohen në përputhje me planin e veprimt të paraparë në planin hapësinor të ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë”, me rend sipas rëndësisë, mundësisë për t’u realizuar dhe urgjencës që e kanë për t’u realizuar.
- Plani hapësinor i ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” do të zbatohet në tri etapa:
 - Etapa e parë përfshin periudhën deri në 4 vjet pas hyrjes në fuqi të planit. Brenda kësaj periudhe do të realizohen projektet apo aktivitetet që janë më urgjente, janë të rëndësishme dhe me mundësitë më të mëdha për t’u realizuar.
 - Etapa e dytë përfshin periudhën deri në 7 vjet pas hyrjes në fuqi të planit. Brenda kësaj periudhe do të realizohen projektet apo aktivitetet që janë të rëndësishme, por më pak urgjente se sa ato të etapës së parë.
 - Etapa e tretë përfshin periudhën deri në 10 vjet pas hyrjes në fuqi të planit. Brenda kësaj periudhe do të realizohen projektet apo aktivitetet që janë të rëndësishme por që nuk janë urgjente dhe me mundësi më të vogla për t’u realizuar.

5.4. Elementet dhe udhëzimet për hulumtim të mëtutjeshëm

- Në ZIV „SHP.UÇK.Kleçkë dhe Divjakë” ka pejsazhe të bukura natyrore që si të tilla paraqesin një vlerë të respektuar natyrore. Kjo vlerë diku-diku në zonë mund të jetë më e shprehur, prandaj shtrohet nevoja e hulumtimit për gjetjen e vendeve në zonë me vlera më të spikatura natyrore në mënyrë që ndoshta edhe ndonjë vend tjetër përveq monumentit natyror „Guri i Gradinës” të mbrohet me ligj si trashëgimi e çmuar natyrore.



Instituti për Planifikim Hapësinor

PLANI HAPËSINOR

**Zona e Interesit të Veçantë
“Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-ës Kleçkë dhe Divjakë”**

Prishtinë, Shkurt 2012.



Anexet:



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E LIPJANIT

Kryetari i Komunës

1nr.464-151

Duke u bazuar në rrolin dhe rëndësinë e luftës së UÇK-së në Kosovë, e në akcent të veçantë në teritorin e Komunave Lipjan, Malishevë dhe Drenas, ku për këto Komuna dhe më gjërë, ka qenë vendosur Shtabi i UÇK-së në disa shtëpi private të fshatit Divjakë dhe Kleçkë, dhe me qëllim që të ruhet natyra e ktyre objekteve me rëndësi të veçantë ashtu sikur kanë qenë gjatë luftës, nga vullneti i lirë i ktyre komunave të lartshënuara, dhe pjesëmarrës aktiv të UÇK-së me dt. 17.02.2010 marrin këtë:

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

I. Për shpalljen e interesit të përgjithshëm për një sipërfaqe prej 41.00,00 ha, e cila sipërfaqe do të kompenzohet, si dhe

II. Për shpalljen e interesit të përgjithshëm si zonë në mbrojtje të veçantë.

Me këtë memorandum mirëkuptimi, do të bëhet përgatitja paraprake procedurale e ngastrave kadastrale për secilin pronar veq e veq në ZK Divjakë dhe ZK Kleçkë, si dhe të zhvillohet procedura edhe për një sipërfaqe më të gjerë, që do të shpallet Zonë me interes të mbrojtjes së veçantë.

Ky memorandum nga tri Komunat e lartshënuara do t'i dërgohet Ministrisë së Planifikimit Hapsinor të Kosovës që të bëjë Propozim-Vendimin, Qeverisë së Kosovës, për qëllim siq u cek ma lartë.

Procedurat e matutjeshme, pas marrjes së Vendimit nga ana e Qeverisë së Kosovës do të zbatohen procedurat e kompenzimit dhe përkufizimit në hartat gjeodezike të kadastrit në secilin ZK të seciles Komunë.

Këtu do të përfshihet edhe kompleksi memorial i varrezave të UÇK-së.

Procedurat administrative do të zhvillohen nga ana e organeve administrative komunale, në bashkëpunim me organet tjera në nivel të Kosovës.

Për zbatimin e Vendimit të Qeverisë deri te përfundimi i të gjitha ktyre, obligohet secili Kryetar i se cilës Komunë Lipjan, Malishevë dhe Drenas, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për shpronësim dhe Ligjit për planifikim hapsinor të Kosovës.

Lipjan 17.02.2010 Kryetar i Komunës z. Shukri Buja

Drenas 17.02.2010 Kryetar i Komunës z. Nexhat Demaku

Malishevë 17.02.2010 Kryetar i Komunës z. Misni Kilaj

Anexi 1

Anexi 2



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra për Implementimin e Projekteve/ Kancelarija za implementaciju Projekata/Office for Project Implementation

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:		z. Mahir Yağcılar, Ministër i MMPH-së			
CC:		z. Emin Krasniqi, zv. Ministër i MMPH-së			
PËRMES/PREKO/THROUGH:		z. Arben Çitaku, U.D. Sekretar i Përhershëm i MMPH-së			
NGA/OD/FROM:		Departamenti i Planifikimit Hapësinor Adnan Elshani /Udhëheqës - Divizioni i Planifikimit Qendror			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Propozim Vendim për Qeveri -Shpallja e interesit të përgjithshëm nacional për Zonën " Shtabi i UÇK-së Kleçkë dhe Divjake"			
Nr. i zyrës:		Lokacioni:	Prishtinë	Data:	05.03.2010
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ ZA AKTIVNOST/ FOR ACTION					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ ZA USVAJANJE/ FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ ZA POTPIS/ FOR SIGNATURE					<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ ZA KOMENTARE/ FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/ VASA PAZNJA/ YOUR ATTENTION					<input checked="" type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/ KAKOJE RASPRAVLJENO/ AS DISCUSSED					<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/ KAKO JE ZATRAZENO/ AS REQUESTED					<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/ BELESKA I ODGOVOR/ NOTE AND RETURN					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ ZA VASU INFORMACIJU/ FOR YOUR INFORMATION					<input checked="" type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROQ/ DEADLINE					

Adresa: Ndërtesa Qeveritare (ish Pallati i Shtypit) -10.000 Prishtinë-Kosovë
 Telefon: + 381 517 553
<http://www.rks-gov.net/mmp/>

Propozim Vendim për shpalljen e hapësirës së "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë" si zonë e veçantë

Në bazë të autorizimeve dhe përgjegjësiave që kanë Institucionet e Kosovës, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe mbi shpalljen e Ligjit për Planifikim Hapësinor, I miratuar nga Kuvendi I Kosovës, Ligjit mbi Shpronësimin, Ligjit mbi Mbrojtjen e Natyrës, Ligji mbi trashëgimin kulturo historike Qeveria e Republikës së Kosovës mund të shpallë zonë të veçantë, hapësirën ku gjendet “Shtabi I Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë”, në bazë të nenit 12.2 dhe 16.4 të Ligjit për Planifikim Hapësinor.

Përshkrim

Për ti bërë ballë Spastrimit etnik dhe gjenocidit ndaj kombit shqiptar si dhe ekzodi masiv prej Kosovës me dhunën dhe tmerrin që u shkaktuan nga agresioni i regjimit totalitar të Sërbisë, e posaçërisht pas vitit 1989, kulminuan me luftën e vitit 1998 dhe 1999.

Por, me nismën e UÇK-së, ku edhe formuan shtabin e përgjithshëm të UÇK-së e që u vendos në Bjeshkët e Berishës në Kleçkë dhe Divjakë. Këtu nisën rreshtimet, uniformimet dhe trajnimet e para të ofensivave kundër okupatorit, u caktuan veprimet e ushtrisë më të re në Botë dhe paraqitjet e para të përfaqësuesve të ushtrisë.

Ishte një ushtri kryesisht e dalën nga populli , ku populli edhe e ndihmoi , e vendosi në shtëpitë, si shtabin dhe ushtarët, hapi ambulancat e para, ku u operuan dhe shëruan shumë ushtarë dhe civil. Poashtu këtu dëshmitë më të forta janë edhe varrezat e Dëshmorëve të vendosura po në këtë zonë.

Poashtu në këtë zonë gjatë kohës së luftës u vendosën një numër i madh i popullatës, të cilët duke qenë nën mbrojtjen e UÇK-së i shpëtuan më të keqes.

Në këtë zonë gjenden edhe hapësira të trashëgimi natyrore; “Guri i Gradinës”; monument i natyrës i karakterit gjeomorfologjik, kategoria e tretë.

Poashtu këtë guri duke pas parasysh pozitën strategjike, Ushtria Çlirimtare e Kosovës e ka përdorur si pikë strategjike vrojtimi.

I gjithë kombi shqiptar, në çdo hap përmend luftën e lavdishme të UÇK-së, sakrificën dhe qëndrueshmërinë e popullit, të luftëtarëve, të komandës së shtabit të përgjithshëm në Kleçkë dhe Divjakë, që gjendej në bjeshkët e Berishës , që njihet si simbol i qëndrueshmërisë së pamposhtur shqiptare. Poashtu edhe pas përfundimit të luftës paraqitet nevoja e rregullimit të varrezave, shtëpive shtabe dhe hapësirës përreth me qëllim që të mos harroi sakrificën e madhe, vlerën, luftën e drejtë dhe qëllimet sublimë, për të cilën shumë komandant ,

ushtarë, familje dhe individ, dhanë jetën. Në këtë mënyrë përveç rëndësisë së historisë së re të popullit tonë plotësohet edhe një pjesë e borxhit ndaj Luftës së drejt çlirimtare të UÇK-së dhe aspiratave të popullit tonë për liri dhe pavarësi.

Iniciativa e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Malishevës dhe Drenasit që të ndërtohet, mbrohet dhe konservohen disa objekte të hapësirës ku vepronte “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së” në Kleçkë dhe Divjakë dhe i njëjti të shpallet zonë e veçantë, flet se lufta të jetësohet dhe përkujtohet përgjithmonë nga; Drenica, Kosova, Kombi Shqiptar dhe mbarë bota përparimtare.

Qëllimi

Marrja e vendimit për shpalljen e Kësaj zone me interes të veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë” si zonë e veçantë ka rëndësi të madhe historike, kulturore dhe strategjike për të dëshmuar për një ngjarje të rëndësishme, për sakrificën dhe dashurinë për liri para gjeneratave të tashme dhe atyre të ardhme. Tek vizitorët kjo zone ku përfshinë varrezat e Dëshmorëve, shtabin, ambulancat hapësirën dhe objektet e tjera që kanë rëndësi natyrore do të zgjojë përjetime, respekt dhe pietet të thellë ndaj Dëshmorëve dhe viktimave që sakrifkuan jetën e tyre.

Kërkesa jonë për shpalljen e “Shtabit të Përgjithshëm në Kleçkës” si zonë me vlerë të veçantë historike, kulturore dhe natyrore bazohet në nenin 12.2 të Ligjit Për Planifikim Hapësinor dhe përfshin sipërfaqen prej 1500,29 ha.

Në nenin 16.4 të Ligjit për Planifikim Hapësinor përcaktohet përmbajtja e propozimit për marrjen e vendimit për nxjerrjen e planeve hapësinore, organi kompetent për hartimin dhe nxjerrjen e planit si dhe institucionet përgjegjëse të cilat duhet t’i sigurojnë burimet financiare për përgatitjen e tyre.

Duke pasur parasysh se shumica e sipërfaqeve janë prona private, kompensimi I pronave do të bëhet sipas Ligjit mbi Shpronësimin,

Baza juridike

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-139 /2009 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Neni - 4, paragrafi 1 dhe paragrafit 3.3.11 dhe 3.3.14 Organi shpronësues parasheh mënyrën e Shpronësimi të pasurisë së paluajtshme dhe qëllimin e ndërtimit.

Prandaj duke u bazuar në të gjitha dispozitat e ligjeve të lartpërmendura propozohet dhe kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës të nxjerrë vendim për shpalljen e kësaj zone si zonë të veçantë e cila gjendet në kuadër të territorit të Komunës së Lipjanit, Drenasit dhe Malishevës.

Anexi 2

MMPH-ja propozon këto zona kadastrale:

KK Malishevë:

Zona kadastrale Lladroc, me gjithsejtë 1/1 parcela prej të cilave 1/1 janë shoqërore, Zona kadastrale Senik me gjithsejtë 1/1 parcela prej të cilave 1/1 janë Publike, Ekonomia e pyjeve.

KK Lipjan:

Zona kadastrale Divjakë me gjithsejtë 68 parcela të gjitha pronë Private
Zona kadastrale Kleçkë me gjithsejtë 20 parcela të gjitha pronë Private

KK Drenas:

Zona Kadastrale Arllat me gjithsejtë 7 parcela te gjitha pronë e Ekonomia së pyjeve
Zona Kadastrale Kizhnarekë me gjithsejtë 27 parcela te gjitha pronë e Ekonomia së pyjeve
Zona Kadastrale Komoran me gjithsejtë 2 parcela te gjitha pronë e Ekonomia së pyjeve
Zona Kadastrale Llapushnik me gjithsejtë 9 parcela te gjitha pronë e Ekonomia së pyjeve
Zona Kadastrale Nekoc me gjithsejtë 36 parcela te gjitha pronë e Ekonomia së pyjeve

Parcelat që i përfshinë zona e "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë" janë gjithsej 171 prej të cilave 83 janë shoqërore kurse 88 janë private.

Burimet juridike

Ligjit Për Planifikim Hapësinor nr.2003/14 i datës 03.07.2003
Ligjit Nr.03/L-139 /2009 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme
Ligji i mbrojtjes së natyrës- rregullorja 206/22
Ligji për trashëgiminë kulturore 02/L-88/2006

Kësaj shkrese i bashkëngjitet dokumentacioni i dorëzuar nga komuna e Lipjanit, Drenasit dhe Malishevës

- Memorandum mirëkuptimi ne mes te tri komunave i datë: 17.02.2010
- Shkrese për iniciimin procedurës nga KK Lipjan
- Vendimi për mbrojtjen e vlerave të natyrës në territorin e komunës së Drenasit,
- Dokumentacionin kadastral me te dhënat për parcelat ne lista te veçanta për secilën zonë kadastrale te komunës përkatëse,
- Hartat me paraqitjet e kufirit te zonës për interes te pergjitheshem ne Bjeshkët e Berishës "Shtabi I Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë", në bazë të nenit 12.2 dhe 16.4 të Ligjit për Planifikim Hapësinor.

Anexi 2

KK Lipjan			
ZK Kleçkë			
Pronari/Poseduesi	Nr i parcelës	Siperfaqja (m2)	Siperfaqja (ha)
Private	55-0	5356	0.5356
Private	53-0	2249	0.2249
Private	52-0	2180.2	0.21802
Private	51-0	2356.9	0.23569
Private	50-0	2233.5	0.22335
Private	47-0	3833.6	0.38336
Private	46-0	2963.8	0.29638
Private	45-0	2531.2	0.25312
Private	44-0	7540.6	0.75406
Private	43-0	2225.2	0.22252
Private	42-0	5652.1	0.56521
Private	41-0	3245.3	0.32453
Private	38-0	61.9	0.00619
Private	9010-0	93.6	0.00936
Private	498-0	6.8	0.00068
Private	499-0	2371.6	0.23716
Private	457-2	568.7	0.05687
Private	457-1	526.9	0.05269
Private	459-0	3250	0.325
Private	9010-0	267.9	0.02679
	TOTAL	49514.8	4.95148
ZK Divjakë			
Pronari/Poseduesi	Nr i parcelës	Siperfaqja (m2)	Siperfaqja (ha)
Private	162-0	29310.6	2.93106
Private	161-0	24570.1	2.45701
Private	136-0	7465.3	0.74653
Private	139-0	1635.9	0.16359
Private	137-0	8680.1	0.86801
Private	153-0	1002.5	0.10025
Private	154-0	988	0.0988
Private	138-0	3047.6	0.30476
Private	152-0	1153.2	0.11532
Private	151-0	3712	0.3712
Private	155-0	1190.8	0.11908
Private	156-0	922.1	0.09221
Private	159-0	1488.6	0.14886
Private	160-0	1533	0.1533
Private	180-0	2247.2	0.22472
Private	174-0	482.6	0.04826
Private	176-0	887.9	0.08879
Private	175-0	2377	0.2377
Private	169-0	1058.5	0.10585
Private	168-0	741.2	0.07412
Private	173-0	1012.4	0.10124
Private	171-0	1308.3	0.13083
Private	163-0	5091.8	0.50918
Private	179-0	6219.6	0.62196
Private	164-0	9417.6	0.94176

KK Malishevë			
Senik			
Pronari/Poseduesi	Nr i parcelës	Siperfaqja (m2)	Siperfaqja (ha)
Ekonomia e Pyjeve	1	633,711.3	63.4
ZK Lladrovç			
Pronari/Poseduesi	Nr i parcelës	Siperfaqja (m2)	Siperfaqja (ha)
Pasuri shoqërore KK Malishevë	1015-2	480,138.0	48.0
	TOTAL	1113849.30	111.38

Anexi 2

Ekonomia e Pyjeve	2448-0	3543.70	0.35
Ekonomia e Pyjeve	1914-0	1513.80	0.15
Ekonomia e Pyjeve	2450-0	2921.00	0.29
Ekonomia e Pyjeve	1912-0	793643.60	79.36
Ekonomia e Pyjeve	1969-0	7734.80	0.77
Ekonomia e Pyjeve	2060-0	1958894.40	195.89
	Total	2775846.40	277.58
ZK Nekoc			
Pronari/Poseduesi	Nr i parcelës	Siperfaqja (m2)	Siperfaqja (ha)
Ekonomia e Pyjeve	1132-0	1.50	0.00
Ekonomia e Pyjeve	1115-0	11.50	0.00
Ekonomia e Pyjeve	1116-0	31.30	0.00
Ekonomia e Pyjeve	1117-0	2266.80	0.23
Ekonomia e Pyjeve	1114-0	15.20	0.00
Ekonomia e Pyjeve	1079-0	5900.10	0.59
Ekonomia e Pyjeve	1140-0	3952.50	0.40
Ekonomia e Pyjeve	1467-0	5562.60	0.56
Ekonomia e Pyjeve	1470-0	736328.50	73.63
Ekonomia e Pyjeve	1466-0	171.50	0.02
Ekonomia e Pyjeve	1479-0	12078.60	1.21
Ekonomia e Pyjeve	1468-0	5588.60	0.56
Ekonomia e Pyjeve	1462-0	1693.70	0.17
Ekonomia e Pyjeve	1135-0	91976.50	9.20
Ekonomia e Pyjeve	1136-0	4558.00	0.46
Ekonomia e Pyjeve	1138-0	1246.90	0.12
Ekonomia e Pyjeve	1139-0	3750.90	0.38
Ekonomia e Pyjeve	1459-0	4.30	0.00
Ekonomia e Pyjeve	1460-0	1859.80	0.19
Ekonomia e Pyjeve	1461-0	6160.50	0.62
Ekonomia e Pyjeve	1124-0	8601.60	0.86
Ekonomia e Pyjeve	1141-0	1006555.10	100.66
Ekonomia e Pyjeve	1137-0	4278.40	0.43
Ekonomia e Pyjeve	9004-0	329.60	0.03
Ekonomia e Pyjeve	1119-0	399.50	0.04
Ekonomia e Pyjeve	1123-0	1201148.40	120.11
Ekonomia e Pyjeve	1078-0	1320639.10	132.06
Ekonomia e Pyjeve	1473-0	8926.60	0.89
Ekonomia e Pyjeve	969-0	15724.30	1.57
Ekonomia e Pyjeve	968-0	12.30	0.00
Ekonomia e Pyjeve	1133-0	18903.60	1.89
Ekonomia e Pyjeve	1118-0	1734.10	0.17
Ekonomia e Pyjeve	1121-0	1045.80	0.10
Ekonomia e Pyjeve	1134-0	30086.80	3.01
Ekonomia e Pyjeve	1483-0	4157.20	0.42
Ekonomia e Pyjeve	1131-0	109106.30	10.91
	Total	4614808.00	461.48
TOTAL DRENAS:		13546696.40	1354.67

Anexi 2


KK Drenas			
ZK Arllat			
Pronari/Poseduesi	Nr i parcelës	Siperfaqia (m2)	Siperfaqja (ha)
Ekonomia e Pyjeve	2353-0	1048.80	0.10
Ekonomia e Pyjeve	2352-0	2323.70	0.23
Ekonomia e Pyjeve	2356-0	1258.00	0.13
Ekonomia e Pyjeve	2357-0	3636.70	0.36
Ekonomia e Pyjeve	9008-0	2384.40	0.24
Ekonomia e Pyjeve	2532-0	12692.20	1.27
Ekonomia e Pyjeve	2358-0	2193327.70	219.33
Ekonomia e Pyjeve			
	TOTAL	2216671.50	221.67
ZK Kizhnarekë			
Pronari/Poseduesi	Nr i parcelës	Siperfaqia (m2)	Siperfaqja (ha)
Ekonomia e Pyjeve	874-0	157692.30	15.77
Ekonomia e Pyjeve	892-0	96.30	0.01
Ekonomia e Pyjeve	894-0	49.10	0.00
Ekonomia e Pyjeve	897-0	144.30	0.01
Ekonomia e Pyjeve	898-0	488.00	0.05
Ekonomia e Pyjeve	889-0	122.40	0.01
Ekonomia e Pyjeve	881-0	8621.30	0.86
Ekonomia e Pyjeve	879-0	867.50	0.09
Ekonomia e Pyjeve	901-0	8981.10	0.90
Ekonomia e Pyjeve	900-0	1753.80	0.18
Ekonomia e Pyjeve	902-0	3737.40	0.37
Ekonomia e Pyjeve	903-0	371.30	0.04
Ekonomia e Pyjeve	904-0	1035.20	0.10
Ekonomia e Pyjeve	905-0	2866.20	0.29
Ekonomia e Pyjeve	906-0	1600.30	0.16
Ekonomia e Pyjeve	877-0	760.80	0.08
Ekonomia e Pyjeve	896-0	415.20	0.04
Ekonomia e Pyjeve	873-0	1319333.50	131.93
Ekonomia e Pyjeve	909-0	1473.00	0.15
Ekonomia e Pyjeve	849-0	2802.30	0.28
Ekonomia e Pyjeve	878-0	1105.40	0.11
Ekonomia e Pyjeve	991-0	7791.40	0.78
Ekonomia e Pyjeve	876-0	1448.40	0.14
Ekonomia e Pyjeve	907-0	1188659.20	118.87
Ekonomia e Pyjeve	908-0	895.70	0.09
Ekonomia e Pyjeve	880-0	4646.30	0.46
Ekonomia e Pyjeve	882-0	346.90	0.03
	TOTAL	2718104.60	271.81
ZK Komoran			
Pronari/Poseduesi	Nr i parcelës	Siperfaqia (m2)	Siperfaqja (ha)
Ekonomia e Pyjeve	1287-0	1221211.60	122.12
Ekonomia e Pyjeve	1288-0	54.30	0.01
	Total	1221265.90	122.13
ZK Llapushnik			
Pronari/Poseduesi	Nr i parcelës	Siperfaqia (m2)	Siperfaqja (ha)
Ekonomia e Pyjeve	2462-0	6138.40	0.61
Ekonomia e Pyjeve	1913-0	4609.00	0.46
Ekonomia e Pyjeve	2430-0	2986.10	0.30

Anexi 2

Private	165-0	13273.5	1.32735
Private	166-0	7472.2	0.74722
Private	167-0	5131.2	0.51312
Private	172-0	1331.5	0.13315
Private	178-0	3797.3	0.37973
Private	177-0	7927.7	0.79277
Private	170-0	5200.7	0.52007
Private	150-0	3363	0.3363
Private	149-0	3137.6	0.31376
Private	144-1	2693.3	0.26933
Private	146-0	722.6	0.07226
Private	145-0	35823.4	3.58234
Private	158-0	35983.9	3.59839
Private	157-0	23146.1	2.31461
Private	143-0	5100.7	0.51007
Private	144-2	12643.1	1.26431
Private	147-0	3319.5	0.33195
Private	148-0	5246.4	0.52464
	Total	292857.6	29.28576
	TOTAL	342372.4	34.23724
		342374	34.2374

Anexi 2

Anexi 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm/Kancelarija Stalnog Sekretara/Office of the Permanent Secretary

DATË/A:	28.03.2010
REFERENC-Ë:	ZSP- 161/10
PËR/ZA/TO:	Fitim Krasniqi, Sekretar i Përhershëm i ZKM-së
CC:	Eset Rama, Drejtor i SKQ-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, U.D. Sekretar i Përhershëm i MMPH-së <i>Arben</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për pikë të rendit të ditës

I nderuari Z. Sekretar,

Ju lutemi që për mbledhjen e radhës së Qeverisë së Republikës së Kosovës të futet si pikë e rendit të ditës propozim vendimi lidhur me shpalljen e interesit të përgjithshëm nacional për Zonën " Shtabi i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë".
 Bashkangjitur me këtë shkresë përcjellëse gjeni propozim vendimin si dhe një përmbledhje të përgjithshme.

Me respekt,

Anexi 4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 2/117

Datë: 30.03.2010

Në mbështetje në nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01 /2007, Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, dhe Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nenit 12.2 dhe 16.0 Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 30 mars 2010, mori:

V E N D I M

1. Hapësira ku ka qenë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-ës, në Kleçkë dhe Divjakë, me sipërfaqe prej 1.500,29 ha në komunat; Lypjan, Malishevë dhe Drenas shpallet zonë me interes të veçantë.
2. Për zbatimin e pikës 1. të këtij vendimi obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe komunat; Lypjan, Malishevë dhe Drenas.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Komunës - Lypjan
- Komunës - Malishevë
- Komunës - Drenas
- Arkivit të Qeverisë

Anexi 5



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REP. OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Njësia Org. Org. Iedritrice Org. Unit	SP
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	1925/10
Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages	- 02 -
Data: Datum: Date:	24/08/2010
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm/Kancelarija Stalvog Sekretara/Office of the Permanent Secretary

Në mbështetje të nenit 145, paragrafi 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 5 paragrafi 5.4. pika (c) të Rregullores Nr.2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Vendimit të Qeverise me Nr.02/117 i datës 30.03.2010, Sekretari i Përhershëm i MMPH-së me datë 24.08.2010 nxjerr:

V E N D I M

I. Formohet Grupi Punues Ministror për hartimin e Planit Hapësinor për Zonën e Veçantë "Kleçkë dhe Divjakë", në këtë përbërje:

1. Shpend Agaj, IPH - Koordinator
2. Festa Nela, IPH- anëtare
3. Rizah Murseli, IPH - anëtar
4. Besim Gollopeni, IPH- anëtar
5. Adnan Elshani, IPH - anëtar

II. GP do të jetë mbështetje profesionale dhe organizative gjatë tërë procesit të hartimit të Planit Hapësinor për Zonën e Veçantë "Kleçkë dhe Divjakë";

III. GP paraprakisht harton planin e vet të punës me të gjitha detajet e nevojshme duke përfshirë edhe raportimet periodike për realizimin e tij;

IV. Koordinator i projektit është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të hartimit të dokumenteve dhe zbatimin e planit të punës së GP;

V. Anëtarët e GP punojnë nën mbikëqyrjen e koordinatorit dhe janë përgjegjës për mbulimin e fushave sektoriale që përfaqësojnë;

VI. Të gjitha vendimet merren me pajtueshmëri të plotë.

Faqe 1 nga 2


Adresa: ish pallati i mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
 Telefon/Faks: + 381 38 200 32 307; +381 38 200 32 245
<http://www.mmph-ks.org> E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

- VII. Anëtarët e GP propozojnë anëtarët e sektorëve tjerë të Qeverisë, të cilët në një moment të përshtatshëm do ti bashkëngjiten punës së GP;
- VIII. GP por edhe anëtarët veç e veç me qëllim të sigurimit të informatave shtesë, janë përgjegjës për organizimin dhe mbajtjen e takimeve me pjesëmarrës tjerë;
- IX. GP është përgjegjës për shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit ekzistues;
- X. GP është përgjegjës për organizimin dhe mbajtjen e takimeve të ndryshme publike;
- XI. Plani është paraparë të jetë rezultat i punës së përbashkët të të dyja palëve – GP-së që përfaqëson nivelin qendror dhe autoritetet përgjegjëse komunale, ku dinamika e punëve, përpjekja dhe angazhimi i GP do të varët nga plani më parë i dakorduar me përgjegjësit e Komunës së Drenasit, Lipjanit dhe Malishevës;
- XII. Plani Dinamik i punës do të përcaktojë në detaje, përgjegjësitë dhe angazhimin e secilës palë në këtë plan.
- XIII. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues,
- Kabinetit të Ministrit, MMPH
- Zyrës së SP-së, MMPH,
- Të gjitha departamenteve të MMPH-së
- Arkivit Qendror të MMPH-së

U.D. Sekretar i Përhershëm


Arben Çitaku



Faqe 2 nga 2

Adresa: ish pallati i mediave “ Rilindja” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 200 32 307; +381 38 200 32 245
<http://www.mmph-ks.org> E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Anexi 5

Anexi 6

**DETYRA PROJEKTUESE****Hartimi i Planit Rregullues****për Zonën me interes të Veçantë "Kleçkë dhe Divjakë"****Hyrje**

Tërësia hapësinore kulturo-historike "Kleçkë - Divjakë" është shpallur "Zonë me interes të veçantë për Kosovën", për arsye të vlerave të veçanta historike, kulturore si dhe vlerave natyrore. Duke i pasur parasysh këto vlera, zona në fjalë paraqitet si njëra ndër tërësitë më të rëndësishme jo vetëm për territorin ku shtrihet por edhe për Kosovën në tërësi.

Momentalisht është duke u zhvilluar procesi i hartimit të Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Kleçkë - Divjakë (në tekstin e mëtejshëm: Plani) me të cilin do të definohen: caqet e përgjithshme të zhvillimit të territorit (hapësirës), do të definohen qartë organizimi dhe destinimi i hapësirës, do të përcaktohen kushtet dhe masat e shfrytëzimit, rregullimit dhe mbrojtjes së zonës në tërësi. Deri më tash janë përfunduar disa hapa të procesit dhe konsiderojmë se ekzistojnë të gjitha parakushtet që paralelisht me këtë proces, të fillohet edhe me planifikimin më detaj të disa zonave specifike.

Prandaj, duke i pasur të gjitha këto parasysh dhe duke respektuar rregullat në fuqi, propozohet hartimi i Planit Rregullues Urban për disa pika që ndodhen brenda kufirit të Planit. Jemi të sigurt se një veprim i tillë do të ndikojë në përshtetjen e aktiviteteve në përgjithësi, të cilat nuk do ta dëmtojnë idenë e konceptit të përgjithshëm të zhvillimit hapësinor të zonës.

Qëllimi i hartimit të Planit Rregullues Urban

Hartimi i Planit Rregullues për Zonën e Interesit të Veçantë "Kleçkë - Divjakë" ka për qëllim kontrollimin dhe menaxhimin e shfrytëzimit të tokës brenda zonës, si dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik duke pasur kujdes maksimal ruajtjen e mjedisit.

Me planin rregullues synohet që:

- te vendoset rregull i caktuar për ndërtimin/zhvillimin dhe mënyrën racionale të shfrytëzimit të tokës, me të cilin arrihen efektet e caktuara të cilat kërkohen nga normat urbane dhe mjedisore;
- të mbrojtë zonën nga zhvillimet e pakontrolluara që mund të ndodhin nga investitorët dhe ndërtuesit potencial;
- te realizohet mbrojtja e elementeve karakteristike historike dhe mjedisore brenda dhe në afërsi të zonës;
- të përpilohet baza e të dhënave (databaza) në sistemin GIS;
- të arrihet parimi i pjesëmarrjes publike në të gjitha fazat.
- të realizohet incizimi gjeodezik detaj i lokacionit, i cili duhet të jetë pjesë e posaçme në detyrës për hartimin e planit. Ai do të mundësojë që të dhënat fizike të merren në mënyrë të saktë dhe të krijohet një bazë katastrale e cila ndihmon ndërtimin e një sistemi gjeografik të informatave të bazuar në gjendjen më të re.

Baza ligjore

Plani rregullues duhet të kuptohet si dokument teknik-normativ me të cilin në mënyrë precize përcaktohen rregullat bazë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e tokës në zonë. Rregullat


duhet të përcaktohen duke ruajtur, vizionin, konceptin dhe të gjitha qëllimet themelore që dalin nga draft Planin Hapësinor për zonën dhe duke u bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor, Udhëzimin Administrativ mbi përmbajtjen e Planit Rregullues Urban, Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, Ligjin për ndërtim, Ligjin për trashëgiminë Kulturore, Ligjin mbi rrugët, Planin Hapësinor të Kosovës, Planet zhvillimore për komunat përkatëse dhe dokumentet që dalin gjatë procesit të planifikimit.

Sipërfaqja dhe kufiri i Planit

Lokacioni i gjerë

Zona me interes të veçantë “Kleçkë dhe Divjakë”, shtrihet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës, përkatësisht pjesa veriore i takon Komunës së Drenasit, pjesa lindore Komunës së Lipjanit, pjesa perëndimore i takon territorit të Komunës së Malishevës dhe një pjesë shumë e vogël i takon territorit të Komunës së Suharekës.

Sipas vendimit të Qeverisë sipërfaqja e përgjithshme e lokacionit është 1.500 Ha e cila, pas takimeve me pjesëmarrës të ndryshëm dhe analizave në terren u plotësua dhe territori i zonës së gjerë ka sipërfaqen prej 4.038 Ha. Pjesa më e madhe e territorit të zonës së gjerë (më tepër se 90%) mbulohet nga pyjet, afërsisht 5% e territorit mbulohet me kulloso dhe tokë bujqësore, dhe pjesa e mbetur i takon banimit dhe disa objekteve tjera përcjellëse.



Harta e lokacionit të gjerë

Lokacioni dhe sipërfaqja e zonave të përcaktuara për Plan Rregullues Urban

Sipas analizave të deritashme të kryera për zonën në tërësi, janë identifikuar disa zona (të prezantuara në hartën e mëposhtme) të cilat duhet të përfshihen në Planin Rregullues Urban:

Zona 1 - Shtëpia muze e “Radio Kosova e lirë” 0.23Ha dhe Agjencia e lajmeve “Kosova Press” 0.20Ha;

Zona 2 – Selia e Përkohshme e Qeverisë së Kosovës 0.68Ha

Zona 3 – Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe spitali ushtarak 81.84Ha


Zona 4 – Lapidari dhe varrezat e dëshmorëve 1.54Ha

Zona 5 – Shtabi i Brigadës 121; 1.85Ha

Zona 6 – Fshati i UÇK-së; 5.0Ha

Zona 7 – Selia e shtabit të Komandant Kumanovës. 0.44Ha

Sipërfaqja e përgjithshme e territorit të ZIV "Kleçkë dhe Divjakë" që do të përfshihet në Planin Rregullues Urban është 91.58Ha Përzgjedhja e zonave është bërë në dakordim me ish pjesëtarët e UÇK-së, përgjegjës për aktivitetet luftarake të kësaj zone dhe në bazë të analizave të zhvilluara në terren.



Harta e zonave të përcaktuara për PRrU në kuadër të ZV "Kleçkë - Divjakë"

Detyra projektuese

Nga hartuesi kërkohet të hartohet Plani Rregullues Urban (PRrU) për zgjidhjen urbanistike arkitektonike të zonave të përcaktuara si më sipër. Lokacioni gjendet në mes të komunave Malishevë, Drenas, Lipjan dhe Suharekë i prezantuar në hartën e lokacionit të gjerë. Brenda

kufijve të lokacionit të gjerë janë përcaktuar disa zona për të cilat duhet të hartohet Plani I përbashkët Rregullues Urban. Prandaj, në mënyrë që të arrihet zgjidhje sa më e mirë, duhet të bëhen të gjitha analizat dhe studimet e nevojshme të cilat do të zhvillohen si një proces I përbashkët në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e interesuar.

Përpos elementeve që janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për përmbajtjen e PRRU-së, dhe kërkesave që dalin nga dokumentet e niveleve më të larta, PRRU për ZV "Kleçkë - Divjakë" duhet të përmbajë edhe normat dhe standardet teknike të përgjithshme për zhvillimin e planit, që së paku duhet të përcaktojnë:


- mënyrën e sigurimit të hyrjeve në lokacion dhe në hapësirën e parkingjeve. Në bazë të analizave të deritashme janë përcaktuar dy pika hyrëse, njëra në afërsi të zones "Fshati i UÇK-së" dhe tjetra në afërsi të objektit të radios "Kosova e Lirë";
- lokacionet e përshtatshme dhe të mjaftueshme për parkingje (nëse është e nevojshme në afërsi të të gjitha zonave, numri i parkingjeve të përshtatet me qëllimet dhe ngjarjet që zhvillohen në zonat përkatëse). Në kuadër të këtyre hapësirave të
- parashihen edhe parkingje të mjaftueshme për biçikleta;
- lokacionet e përshtatshme për vendosjen e objekteve shërbyese/tregtare (qendra protokollare dhe objekti i muzeut në Zonën 3, objekt hotelier me përmasa të përshtatshme për vendin në Zonën 2, pika të vrojtimit, pika të informimit dhe shërbimeve, tabela informuese me formë dhe madhësi të përshtatshme, etj.) dhe
- zgjidhjen e tyre arkitektonike të cilat duhet me qenë në harmoni me mjedisin dhe objektet ekzistuese;
- mënyrën e kycjes në infrastrukturë teknike, të lokacionit në përgjithësi dhe të zonave specifike në veçanti;
- të përcaktohet mënyra e qasjes për persona me aftësi të kufizuara dhe invalidë;
- mënyrën dhe zgjidhjen teknike të furnizimit me ujë;
- mënyrën dhe zgjidhjen teknike të furnizimit të zonës me energji elektrike;
- mënyrën dhe zgjidhjen teknike të ndriçimit adekuat të zonës - të parashihet ndriçimi pranë shtigjeve të ecjes dhe varrezave që janë pjesë e kësaj zone (lloji dhe forma e ndriçimit të jetë në pajtueshmëri me rregullat teknike në fuqi);
- në vende të përshtatshme të parashihet ndalesa për autobusë publik sipas rregullave teknike në fuqi;
- përfshirjen e projektit ekzistues të varrezave të dëshmorëve (Zona 4) në PRRgullues;
- lokacionet e përshtatshme për vendosjen e kontejnerëve të mbeturinave dhe formën e tyre (të parashihet edhe mundësia e kamuflimit adekuat);
- të përcaktohet zgjidhja teknike e gardhit të zonës e cila duhet të jetë e njëjtë për të gjitha zonat, prandaj kërkohet të jetë origjinale, pjesët e dukshme të së cilës patjetër duhet të punohen në kombinim nga druri i qëndrueshëm dhe guri natyror. Lartësia dhe forma të jetë në përputhje me rregullat teknike që i përgjigjen zonës;
- të propozohet mënyrën e renovimit adekuat dhe rikonstruktimit të objekteve ekzistuese me rëndësi të veçantë;
- të përcaktohen lokacionet e përshtatshme dhe zgjidhja teknike e shtigjeve për këmbësorë, me qëllim të lidhjes së zonave karakteristike, të parapara me PRR, gjerësia e të cilave duhet të siguroj lëvizjen e lirë të maksimum dy personave.

Përmbajtjet specifike



Zona 1 (Radio Kosova e Lirë) dhe Agjencia e lajmeve "Kosova Press" – është zonë ku gjatë luftës janë dhënë lajmet nga radioja e atëhershme dhe informimet tjera nga terreni. Me PRrU, në këtë zonë duhet të parashihet:


- zgjidhja urbanistike e zonës duke i përfshirë të gjitha kërkesat e përgjithshme të parapara më sipër;
- rregullimi i shtëpisë ekzistuese që sot është "Shtëpi muze" dhe Agjencia e lajmeve "Kosova Press", me arkitekturë të përshtatshme (duhet patjetër të ruhen gjurmët e zhvillimeve që kanë ndodhur gjatë luftës);



Zona 2 – Selia e Përkohshme e Qeverisë së Kosovës – vend në të cilin Qeveria e atëhershme ka kryer funksionin dhe detyrat për një periudhë të caktuar.

Me PRrU, në këtë zonë duhet të parashihet:

- zgjidhja urbanistike e zonës duke i përfshirë të gjitha kërkesat e përgjithshme të parapara më sipër;
- restaurimi i shtëpisë së Qeverisë së atëhershme me arkitekturë të përshtatshme, duke pasur kujdes ruajtjen e gjurmëve që e theksojnë periudhën e luftës;




Zona 3 – Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe spitali ushtarak – vend ku janë kryer të gjitha detyrat, shërbimet, informimet, aktivitetet e UÇK-së si dhe shërimi dhe ndihma e të plagosurve në shtëpitë – spitalet ushtarake.

Me PRrU, në këtë zonë duhet të parashihet:

- zgjidhja urbanistike e zonës duke i përfshirë të gjitha kërkesat e përgjithshme të parapara më sipër;
- restaurimi dhe ndërtimi i shtëpive që kanë qenë aktive gjatë periudhës së luftës dhe

objektet të cilat kanë shërbyer si spitale ushtarake, me arkitekturë të përshtatshme dhe me elemente që e theksojnë atë periudhë;

- caktimi i lokacionit të përshtatshëm dhe zgjidhja arkitektonike e qendrës protokollare. Forma, madhësia dhe përmbajtja e qendrës të bëhet në përputhje me standardet e përcaktuara për këto qëllime. Varësisht nga zgjidhja në përbërje të qendrës të parashihet edhe një hapësirë për muze të përmasave adekuate;




Zona 4 - Lapidari dhe varrezat e dëshmorëve - vend ku është i ndërtuar një lapidar dhe varreza të dëshmorëve të rënë gjatë luftës në këto anë.

Me PRrU, në këtë zonë duhet të parashihet:

- zgjidhja urbanistike e zonës duke i përfshirë të gjitha kërkesat e përgjithshme të parapara më sipër;
- të konsultohet projekti ekzistues i zonës së Lapidarit dhe varrezave të dëshmorëve, në mënyrë që të bëhet plotësimi me zhvillimet e parapara me këtë plan.
- përcaktimi i lokacionit të përshtatshëm dhe zgjidhja arkitektonike e amfiteatrit gjysmë të mbuluar me kapacitet të mjaftueshëm për

organizimin e manifestimeve të ndryshme kulturore. Forma e amfiteatrit të jetë në përputhje me konfiguracionin e terrenit;

- përcaktimi i lokacionit të përshtatshëm dhe zgjidhja arkitektonike e një qendre informative për tërë Zonën me sipërfaqe të mjaftueshme. Në kuadër të këtij objekti duhet të parashihet një njeje sanitare (me kapacitet që i përgjigjet kërkesave) me të gjitha elementet përcjellëse;




Zona 5 - Shtabi i UÇK-së -Brigada 121 - me PRrU, në këtë zonë duhet të parashihet:

- zgjidhja urbanistike e zonës duke i përfshirë të gjitha kërkesat e përgjithshme të parapara më sipër;
- mënyra e restaurimit të shtëpisë ku ka qenë i vendosur shtabi, shtëpi kjo që sot është e pabanuar dhe e dëmtuar në një shkallë të lehtë, me arkitekturë të përshtatshme dhe me elemente që e theksojnë atë periudhë;
- të propozohet dislokimi i shtallës ekzistuese;
- në anën tjetër të rrugës, të propozohet zgjidhja arkitektonike e një objekti hotelier me kapacitet të mjaftueshëm

(2/3 dhoma njëshe dhe pjesa tjetër dhoma dyshe dhe apartamente), me arkitekturë që i përshtatet konfiguracionit të terrenit dhe nuk e prish peisazhin natyror;

- caktimi i lokacionit të përshtatshëm dhe zgjidhja arkitektonike për një kullë vrojtuese, në të cilin vizitorët do të kënaqen me peisazhet natyrore;

- përcaktimi i lokacionit të përshtatshëm dhe zgjidhja arkitektonike e kompleksit prej disa shitoreve tregtare, të destinuara për shitjen e punimeve artizanale të këtyre anëve dhe shitjen e artikujve ushqimorë vendorë;



Zona 6 - Fshati i UCK-së - me PRrU, propozohet:

- zgjidhja urbanistike e zonës duke i përfshirë të gjitha kërkesat e përgjithshme të parapara më sipër;
- përcaktimi i lokacionit të përshtatshëm dhe zgjidhja arkitektonike e kompleksit të vikend - shtëpive, për nevoja turistike, organizimin e ekskursioneve, përgatitjes fizike të sportistëve dhe aktivitetet tjera të nevojshme, që do të kontribuonin në zhvillimin ekonomik të këtyre anëve. Numri i objekteve do të varet nga zgjidhja urbanistike e bazuar në treguesit aktual turistik të Kosovës në përgjithësi dhe të zonës në veçanti. Forma dhe madhësia e objekteve rekomandohet të jetë e disa tipeve që do të plotësojë nevojat e ndryshme të turistëve. Materiali që do të përdoret për ndërtim (në pjesët e dukshme të objekteve) duhet të jetë

kombinim i drurit të qëndrueshëm, gurit natyror dhe me mbulesë prej tjegullave;



Zona 7 - Brigada 121 “Kumanova” - Komanda e Batalionit të tretë “Sadik Shala” - Luzhnicë. Vend i cili në fillim të luftës ka shërbyer si shtab i UCK-së, mirëpo me vrasjen e komandant Kumanovës, selia e shtabit transferohet në Kleçkë.

Me PRrU, në këtë zonë duhet të parashihet:

- zgjidhja urbanistike e zonës duke i përfshirë të gjitha kërkesat e përgjithshme të parapara më sipër;
- mënyra e restaurimit të objekteve që gjatë luftës kanë shërbyer si shtab.
- të propozohet një zgjidhje urbanistike e zonës duke përfshirë edhe zgjidhjen arkitektonike për hyrjen në zonë dhe shtegun që të drejton në objektet e zonës.

Përgjegjësit kryesor:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 Instituti për Planifikim Hapësinor
 GP për hartimin e Planit Hapësinor për Zonën e Veçantë “Kleçkë - Divjakë”
 Luan Nushi, drejtor
 IPH - MMPH
 Përgatitur, Tetor 2010